

Ana tjetër e medaljes

# TIRANA SI MESAZH, FUSHË-KRUJA SI MODEL

**Takimi në Kukës i kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berishës me kryetarin dhe me kryeministrin e Kosovës, vetëm një ditë pas vizitës së Bushit në Tiranë, është tregues i këtij roli të ri që i është ngarkuar Tiranës zyrtare në këtë fazë delikate për Kosovën. Ky mision bëhet edhe më i rëndësishëm në kontekstin e deficitit të autoritetit që po përjetojnë qeveritarët e Prishtinës në këtë fazë të vonësës së definimit të statusit final të Kosovës.**



**Milazim KRASNIQI**

**V**izita historike dhe spektakolare e presidentit të SHBA-ve, Xhorxh Bushit në Tiranë, sublimoi ndër të tjera edhe ndërgjegjësimin tonë për faktin se jemi transformuar në një komb të bashkuar, i cili edhe flet me një zë për veten e vet. Kjo gjë u pa kësaj here më qartë se asnjëherë më parë në dy nivele. E para, në atë të opinionëve të qytetarëve të thjeshtë shqiptarë dhe e dyta, në adresimin ndaj të gjithë shqiptarëve nga Tirana, kryeqyteti i natyrshëm i tyre.


Opinionet dhe mbresat e qytetarëve të Shqipërisë, në një mënyrë të jashtëzakonshme e theksonin rëndësinë e vizitës së presidentit amerikan, në kontekstin e pavarësimit të Kosovës. Pothuajse asnjë njeri nuk u dëgjua të thoshte se mos kjo do të lehtësonte regjimin e vizave, ose do të rriste vendet e punës. Të gjithë flisnin për Kosovën dhe për pavarësinë e saj. Pra, interesi praktik qytetar e shtetëror u la mënjanë dhe u kalua në theksimin e interesit kombëtar. Nga ana tjetër, rëndësia që iu dha Tiranës në këtë vizitë, tregon se ajo do të jetë qendra e ardhshme, në të cilën do të formësohen mesazhet shqiptare në përmasat rajonale.

Po të shikohen në retrospektivë këto dy gjëra, rezultojnë se ato në të kaluarën kanë qenë të mënjanuara, sado që mund të kenë qenë prezente. Tranzicioni i gjatë dhe i vështirë i Shqipërisë drejt një shoqërie të lirë, pati shtrënguar jashtë mase qytetarët e saj, që të preokupoheshin

më shumë me hallet sociale se sa me brengat kombëtare. Por, në vitin 1999, si përgjigje ndaj tragjedisë së Kosovës, ata harruan hallet e veta dhe iu përkushtuan solidaritetit me bashkëkombasit e tyre. Kështu, filloi ai ndryshim i madh, që solli edhe këtë ndjeshmëri të madhe me pavarësinë e Kosovës. Nga ana tjetër, udhëheqja e Kosovës e viteve nëntëdhjetë, në përpjekje për ta afirmuar Kosovën si entitet më vete, bëri veprime që jo vetëm e veçonin, por edhe e largonin nga Shqipëria. Edhe nëse ishte një kundërpërgjigje ndaj akuzave për planet e fshehta për krijimin e të ashtuquajturës “Shqipëri e Madhe”, ajo tendencë shkoi shumë larg, madje duke e krijuar edhe idenë e një karshillëku provincial e primitiv ndaj Shqipërisë. Mbase kjo tendencë provinciale e primitive do të zgjatej edhe më deri në ndonjë absurd, po të mos ishte kjo vizitë e Xhorxh Bushit në Tiranë, e cila e ngarkoi Tiranën me një mision të ri të përfaqësimit të botës shqiptare.

Takimi në Kukës i kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berishës me kryetarin dhe me kryeministrin e Kosovës, vetëm një ditë pas vizitës së Bushit në Tiranë, është tregues i këtij roli të ri që i është ngarkuar Tiranës zyrtare në këtë fazë delikate për Kosovën. Ky mision bëhet edhe më i rëndësishëm në kontekstin e deficitit të autoritetit që po përjetojnë qeveritarët e Prishtinës në këtë fazë të vonësës së definimit të statusit final të Kosovës.

Në ditët që vijnë dhe në periudhën që pason, shqiptarët duhet të lexojnë me kujdes mesazhet që ka lënë prapa vetes vizita e presidentit amerikan në Shqipëri. Bile, më së shumti duhet të lexohet me kujdes vizita e tij në Fushë Krujë. Banorët e atjeshëm janë me një përbërje të përzier, e me një numër të ndjeshëm edhe nga Kosova. Mbase Fushë Kruja do të jetë fati i ardhshëm i mbarë botës shqiptare, në proceset e mëdha të integrimi rajonale e europiane.



**Tirana, kryeqyteti natyror i shqiptarëve!**

Statusi i Kosovës

# PAVARËSIA SI NDARJE ME TË KALUARËN DHE SI SHPRESË PËR TË ARDHMEN

Statusi do të jetë një mundësi për qytetarët e Kosovës pasi qeveritarët tanë dhe lidhshpëri në përgjithësi nuk do ta kenë arsytim statusin për dështimet e tyre, por do të përballen drejtpërdrejt me qytetarët për gjitha skandalet e tyre.



Gëzim QERIMI

**S**ipas një anketimi të opinionit publik që ka realizuar organizata amerikane në Kosovë USAID, që përfshin shqiptarët dhe serbët e Kosovës, del se arritja e një marrëveshje të përhershme për statusin e Kosovës brenda vitit 2007, konsiderohet si një çështje me rëndësi shumë të madhe për rreth 98 % të shqiptarëve të Kosovës dhe rreth 86% të serbëve me banim në Kosovë.

Për të njëjtat grupe etnike në Kosovë, çështjet e rëndësishme për t'u zgjidhur janë: Statusi politik i Kosovës, zhvillimi ekonomik dhe papunësia.

Mbi 98% e shqiptarëve mendojnë se është thelbësore që Kosova të jetë shtet i pavarur me kufijtë e tanishëm. Ndërsa rreth 80 % e serbëve të Kosovës konsiderojnë se për ta thelbësore është mbetja e Kosovës si krahinë me autonomi të gjerë brenda Serbisë.

Por domosdoshmëria e statusit e tejka-

lon çdo aspiratë patriotike të shqiptarët e Kosovës dhe çdo debat politik që bëhet rreth tij. Ndërsa në mendjet e kosovarëve dominon dëshira e të qenit shtet i pavarur dhe sovran, si një shenjë e qartë e ndarjes përfundimtare me të kaluarën e keqe që kishte Kosova me pushtuesin famëkeq, pushtim i cili kulmoi me një spastrim etnik që ishte tronditës për të gjithë botën e qytetëruar si dhe me masakrat ndaj grave, fëmijëve dhe pleqve. Por tek rinia kosovare statusi shihet edhe si një instrument integrimi në strukturat euro-atlantike. Të rinjtë statusin e lidhin me shumë me të ardhmen, se sa me të shkuarën.

Mungesa e një statusi të qartë e përfundimtar për Kosovën paraqet një rëndësi të madhe për zhvillimin e saj në përgjithësi dhe për kapërcimin e periudhës së tranzicionit në veçanti. Pa status nuk mund të ketë investime të huaja. Ekonomia e Kosovës ka mbetur e shkatërruar dhe jo funksionale për shkak të mos investimeve të huaja. Mungesa e statusit të qartë e përfundimtar për Kosovën po komprometon shumicën e strategjive dhe planeve të zhvillimit të hartuara deri më sot, të cilat po mbesin vetëm në letër. Mos definimi i statusit është gjithashtu pengesë për forcimin e vendit dhe për qartësimin e përgjegjësisë qeverisëse. Shoqëria civile konsideron së mungesa e statusit i pengon ata për

të thënë fjalën e tyre mbi dobësitë dhe skandalet e qeverisjes dhe mbi fenomenet e tjera negative në Kosovë. Shoqëria kosovare, e në veçanti rinia, ndiejnë t'u jetë imponuar mendësia e vetëkontrollit nga frika se debatet dhe protestat mund të ndikojnë për keq në vendimin për statusin. Ne kemi ulur kokën para të gjitha këtyre dukurive të këqija dhe presim me shpresë. Pasi që jemi të bindur që sikur Kosova të ishte shtet i pavarur, qytetarët e saj nuk do të pranonin që të qeverisen në këtë mënyrë, ku shumica e anëtarëve të qeverisë bëjnë skandale dhe nuk e çajnë fare kokën e tyre. Vlen të ceket rasti i fundit i emërimeve të anëtarëve të Bordeve në Kompanitë e mëdha publike të Kosovës, si në PTK, KEK, Aeroport, etj., ku gjitha emërimet ishin politike.

Në anën tjetër, me zgjidhjen e statusit politik të Kosovës nuk duhet të pritet një ndryshim i menjëhershëm i situatës ekonomike. Duhet të merret parasysh se statusi do të sjellë vetëm një mundësi jetësore, por nuk do të ndryshojë menjëherë situatën në të mirë. Statusi do të jetë një mundësi për qytetarët e Kosovës pasi qeveritarët tanë dhe lidhshpëri në përgjithësi nuk do ta kenë arsytim statusin për dështimet e tyre, por do të përballen drejtpërdrejt me qytetarët për gjitha skandalet e tyre. Në shoqëritë demokratike, keq-qeverisja përmirësohet vetëm me presionin e shoqërisë civile.



► Kosova, një shtet i ri në Europë!

Elektroekonomi

# Shkyçen konsumatorët që nuk paguajnë energjinë elektrike

**“Vetëm gjatë ditëve të para të aksionit janë shkyçur 60 konsumatorë të mëdhenj, dhe kjo ka ndikuar pozitivisht, pasi që brenda këtyre ditëve vetëm në komunën e Ferizajt janë inkasuar 90 mijë euro. Procesi i shkyçjes së konsumatorëve ka disa procedura të vështira, sepse duhet të aplikohen masat e sigurisë në këtë proces dhe brenda ditës mund të kyçen rreth pesë konsumatorë e jo më tepër”, ka theksuar drejtoresha e KEK-ut.**

**Lulzim AHMETI**

**P**lani aksional i cili është ndërmarrë gjatë muajit prill nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), ka për qëllim zvogëlimin e numrit të konsumatorëve të cilët nuk e paguajnë energjinë elektrike dhe zvogëlimin e humbjeve të energjisë.

“Në këtë fazë të këtij plani aksional, do të shkyçen konsumatorët ilegalë, ata të cilët nuk e paguajnë fare energjinë, si dhe konsumatorët të cilët kanë riprogramuar borxhet e tyre dhe pas riprogramimit nuk kanë filluar të paguajnë energjinë e shpenzuar”, theksoi Pranvera Dobruna.

Sipas saj ky aksion nuk do të ndërpritet dhe do të vazhdojë edhe në të ardhmen, pasi ky është një proces që zgjat, sepse KEK-u nuk mund ta tolerojë mos pagesën e energjisë elektrike për shkak se çmimi i prodhimit është shumë i lartë, dhe në këtë mënyrë KEK-u nuk mund ta përballojë koston e prodhimit.

“Vetëm gjatë ditëve të para të aksionit janë shkyçur 60 konsumatorë të mëdhenj, dhe kjo ka ndikuar pozitivisht pasi që brenda këtyre ditëve, vetëm në komunën e Ferizajt janë inkasuar 90 mijë euro. Procesi i shkyçjes së konsumatorëve ka disa procedura të vështira, sepse duhet të aplikohen masat e sigurisë në këtë proces dhe brenda ditës mund të kyçen rreth pesë konsumatorë e jo më tepër”, ka theksuar drejtoresha e KEK-ut.

Sa i përket problemeve që ekipet e KEK-ut kanë hasur gjatë procesit të shkyçjeve, Dobruna tha se për këtë edhe kanë kërkuar mbështetje nga Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK), mirëpo sipas saj nuk kanë hasur në ndonjë problem të madh.

Në planin e KEK-ut janë regjistruar 114 mijë konsumatorë pasivë, ku bëjnë pjesë konsumatorët që kanë dy njësor apo konsumator të dyfishtë. KEK-u është zotuar se deri në fund të vitit do t'i ndalë të gjithë keqpërdorimet e konsumatorëve të papërgjegjshëm. Por sa i përket konsumatorëve minoritarë, Dobruna

tha se ndaj të gjithë konsumatorëve që u është faturuar konsumi e që nuk e kanë paguar borxhin e tyre, qofshin ata minoritarë apo jo, do të ketë masa ndëshkuese.

“Do të merren masa edhe ndaj punëtorëve të KEK-ut që kanë keqpërdorur detyrën zyrtare, pikërisht ndaj atyre që kanë ndihmuar konsumatorët që janë shkyçur nga rrjeti që të ri kyçen ilegalisht”, ka thënë drejtoresha e KEK-ut.

Ajo gjithashtu tha se procesi i faturimit tani për tani është në nivelin 70 për qind, kurse vetëm në muajin prill KEK-u ka inkasuar 7.5 milion euro. Dhe sipas saj me shkyçjen e konsumatorëve që nuk e paguajnë dhe të atyre ilegalë, KEK-u do të ketë energji të mjaftueshme dhe nuk do të ketë nevojë për aplikimin e planit A B C.

Aksioni i shkyçjes së konsumatorëve që nuk e paguajnë energjinë elektrike ka filluar në Komunitat Gjilan, Ferizaj, Viti. Ky aksion është shtrirë në gjithë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe vendet ku jetojnë pakicat.

Që nga fillimi i aksionit për shkyçjet e konsumatorëve që nuk e paguajnë energjinë elektrike, nga 21 maji, “janë shkyçur 1600 konsumatorë të vegjël, ndërsa konsumatorë të mëdhenj apo komercial janë shkyçur më shumë se 100” ka thënë zëdhënësja e KEK-ut Donika Kadaj-Bujupi për revistën “PAQJA”.

Shuma më e madhe e konsumatorëve që janë shkyçur deri më tani, që i kanë pasur borxhe KEK-ut, kanë qenë 10000 euro deri në 30000 euro. Këta konsumatorë janë kompani të mëdha që energjinë e përdorin për zhvillimin e biznesit të tyre.

Ndonëse Drejtoresha menaxhuese e KEK-ut Pranvera Dobruna-Kryeziu pati deklaruar se do të hiqet plani A B C, zëdhënësja Kadaj-Bujupi thotë se A B C-ja do të hiqet atëherë kur do të zvogëlohen humbjet. Mesatarja ditore e një blloku të Kosovës A, dhe të dy blloqeve të Kosovës B është 650 MWh deri në 700 MWh energji elektrike. Sipas zyrtarëve të KEK-ut, kjo energji është e mjaftueshme për një shfrytëzim më racional të energjisë, po thuajse tash e tetë muaj KEK-u nuk e ka aplikuar planin A B C, me disa përjashtime kur ka pasur ndonjë prishje.

Momentalisht energjia elektrike në Kosovë paguhet në masën 40 për qind. Gjatë muajit të kaluar Zyra e Rregullatorit për Energji i kishte ngritur tarifën e energjisë dhe për këtë shkak qytetarët filluan të mos e paguajnë energjinë, dhe pagimi i saj ra në masën 25 për qind.

Komuna që më së shumti i ka borxhe KEK-ut është ajo e Prizrenit, ndërsa komuna që e paguan më së shumti energjinë elektrike është Prishtina, ku energjia e shpenzuar paguhet gati 80 për qind – thonë zyrtarë të KEK-ut.

Aksioni për shkyçjen e konsumatorëve që nuk paguajnë do të vazhdojë deri sa të zvogëlohen humbjet dhe derisa pagesa e energjisë elektrike të jetë e kënaqshme.



Korporata Elektroenergjetike e Kosovës

Intervistë me Hafëzin Qahil Kajolli

# Durimi duhet të na shoqërojë edhe për shumë kohë

**Durimi, duhet të jetë shoqëruesi ynë edhe për shumë kohë. Edhe pse në një të ardhme të afërt do të pavarësohemi, kjo nuk na zgjidh problemet dhe varfërinë. Ne nuk e kemi shkopin e Hazreti Musait. Duhet të tolerojmë shumë, t'ia falim gabimet njëri tjetrit sepse të gjithë gabojmë. Prej qeveritarëve kërkoj sinqeritet, transparencë dhe ligje të hapura. Rinia duhet të mundohet të gjejë rrugëzgjidhje për jetesë në vendin e vet, dhe duhet ta punojnë tokën se toka jonë mund të na ushqejë edhe kaq sa jemi.**

**PAQJA:** Si kanë qenë zgjedhjet në rininë tuaj dhe cili është dallimi po t'i krahasojmë me zgjedhjet e tanishme?

**Qahil Kajolli** - Në kohën e ish-Jugosllavisë (mbretërisë të serbëve, kroatëve dhe sllovenëve) unë kam qenë rreth të dymbëdhjetave, kur jam bërë i aftë të kuptoj për zgjedhjet. Në atë kohë kandidat për deputet të zonës sonë të Gilanit ishte Aqif Tetova. Kishte edhe kandidatë të tjerë, por ata të gjithë ishin serbë, emrat që mbaj mend ishin Toma, Rada dhe Zhifki. Eh, kur kujtoj ato zgjedhje rrëqethem tani sepse të moshuarit e dinin fare mirë se shqiptari nuk kishte shans të fitonte. Megjithatë fushata zhvillohej sa për sy e faqe për ne, shqiptarët. Ajo që më kishte ngelur në mendje ishte se Aqif Tetova nuk fitoi

edhe pse shumica dërmuese e popullit ia kishte dhënë votën atij. Këtë e di sepse udhëheqës i grupit të fushatës së Aqifit ishte babi im, Hajrizi. Meqenëse isha adaptuar me zhurmën e fushatës elektorale, heshtja na habiti të gjithëve një ditë pas votimit. Të moshuarit thonin se edhe kësaj radhe fitoi Rada. Si duket ka qenë jo i përshtatshëm për zonën. Natyrisht se shqiptarët për arsye të ndryshme detyroheshin që të merrnin pjesë edhe në fushatat e serbëve. Por më e keqja e tyre ishte pas votimeve. Prej tri ose katër kandidatëve, do të fitonte njëri prej tyre, ndërsa të tjerët do të dënoheshin në forma të ndryshme gjatë tërë kohës katër vjeçare sa ishte ai në pushtet. Ajo që mbaj mend unë ishte se, më së keqi, kalonin grupet e muzikantëve dhe prej tyre ende më keq, kalonin tu-

panxhinjtë sepse ata i njihje secili. Të shkretit nuk kishin ku ta fshihnin tupanin, ndërsa zurlaxhinjtë kalonin më lehtë sepse zurlat i futnin në xhepa.

Në atë kohë shqiptarët edhe pse kandidonin, nuk fitonin. Do të fitonte vetëm ai që ishte i besueshëm i serbëve. Shqiptarët ishin të dënuar, pa marrë parasysh se cili fitonte, Rada, Toma ose Zhifki. Por ja që edhe ato kohëra kaluan e ishalla nuk kthehen më kurrë.

**PAQJA:** Pse mendoni se mund të kthehen?

**Qahil Kajolli** - Nuk i dihet të ardhmes, por personalisht mendoj se kësaj radhe jemi me të fortë dhe uroj të mos na zhgënjë. Por ajo që desha ta përfundoj me përgjigjen paraprake, ju djem tani e keni shumë më lehtë se ne, në kohën tonë. Ne i kishim vështirësitë tona, por ju po më duket se jeni azdisur shumë. Duhet të bëni që të zgjidhen më të mirët, sepse ne jemi shumë të varfër dhe duhet punuar shumë. Deputetët e zgjedhur po më duket se kanë shumë fjalë dhe punë hiç. S'kanë faj, po rrinë pale dhe gjejnë fjalë. Por bashkësinë ndërkombëtare nuk duhet ta zhgënjë me pushtetarë të pa shkolluar. Kosova sot ka njerëz të ditur, ndërsa ne ku t'i gjenim shkollarët!

**PAQJA:** A mendoni se keni bërë një gabim pse keni qenë me Ballin Kombëtar?

**Qahil Kajolli** - Jo, kurrën e kurrës. Nuk mendoj asnjëherë që kam bërë gabim që isha me Ballin Kombëtar, pa marrë parasysh se çfarë propagande zhvillonin kundër nesh. Por historia do t'i vlerësojë angazhimet dhe politikat e Ballit, gjykuar me kohën tonë. Balli Kombëtar filloi si organizatë në vitin 1943. Themelues i tij ishte Sali Myftiu i Shkodrës. Qëllimet ishin shumë të mira. Ne kishim për qëllim bashkimin e trojeve gjithë shqiptare dhe veprimet tona ishin të hapura.



► Hafëzi Qahil Kajolli

**PAQJA: A ka funksionuar sistemi ushtarako-politik tek ju?**

**Qahil Kajolli** - Edhe pse shumica dërmuese e luftëtarëve tanë ishin të pa shkollë, ata ishin të organizuar. Mbaj mend se kam regjistruar mbi pesëqind luftëtarë nën komandën e babit tim, Hysen Tërpeza kishte po aq të angazhuar ose më shumë, Sali Kabashi po ashtu etj. Kur luftës po i afrohej fundi, Shefqet Shkupi si duket kishte kaluar në ilegale. Më vonë kam mësuar se ai paska qenë nga Fieri i Shqipërisë. Ai kishte dëgjuar se formacionet tona po qëndronin edhe më tutje. Shpesh herë ndesheshim me komunistët. Ai një ditë erdhi dhe na tuboi në shtëpinë e Hysen Tërpezës. Në atë takim thuajse ishin krerët kryesorë të brigadave të Ballit Kombëtar nga Drenica, Prishtina, Ferizaj, Gjilani etj. Pas një bisede bukur të gjatë Shefqet Shkupi, që dukej se kishte qenë një diplomat i shkëlqyer, në fund tha: burra, lufta thuhetse po mbaron, ndërsa bota komunistët i njeh si fitimtarë. Ne më së paku duhet të luftojmë mbi tri vjet, sepse bota nuk ka kohë tani të merret me ne, ndërsa nëse pyeten eventualisht serbët se kush po lufton në Kosovë, ata do të përgjigjen se janë kolaboracionistët, mbeturinat e gjermanëve. Bota do të kuptojë se kjo nuk qenka e vërtetë vetëm pas tri katër vjetëve. Kështu janë rregullat e ndërkombëtarëve. Sa për t'u siguruar se ne mund ta kishim përkrahjen e të huajve, nga shtëpia e Sali Kabashit i sollën dy anglezë dhe një amerikan. Ata kishin qenë pilotë që ishin detyruar të lëshohen të rrethin tonë. Edhe pse gjermanët i kishte kërkuar nëpër katund, Salihu i kishte fshehur. Duke qenë se Balli i kishte punët mirë me gjermanët, këta nuk kishin besuar se pilotët ishin strehuar tek Salihu. Me një fjalë pilotët meqenëse kishin edhe radiostacionin me vete, na thanë se ishin të gatshëm të na lidhnin me botën.

**PAQJA: Në cilën gjuhë flisnin ata, dhe çfarë u bë me ta?**

**Qahil Kajolli** - Thashë se Shefqet Shkupi dukej se ishte diplomat. Ai e fliste frëngjishten rrjedhshëm. Ndërsa pilotët kur vërejtën se ne do të dësh-tonim, kërkuan nga ne që t'i dorë-zonim ata në një prej brigadave ushtarake. Ata nuk praninin të binin në duart e milicisë, sepse nuk ju besonin atyre.

**PAQJA: Muhamet Pirraku thotë se babai juaj ka qenë tradhtar, e pastaj më vonë është përmirësuar?**

**Qahil Kajolli** - Po e kam lexuar. Si mund të përmirësohet një tradhtar!? Sikur të ishte i tillë ai nuk do të gëzonte aq autoritet në zonën e tij derisa vdiq më 1981. Më duket se Pirraku nuk i intereson kualiteti, por si e si ta mbushë librin me faqe. Ai çka ka

dëgjuar ka shkruar, nuk është marrë me saktësinë e ngjarjeve. Gjatë një beteje në Hogosht, kufiri i atëhershëm midis shqiptarëve dhe serbëve, vendi për të cilën akuzohet babai im, është vlarë një person. Atë kohë babai ka qenë roje kufitare. Dikush e ka akuzuar babin tim, kinse paska ikur nga fushëbeteja dhe i ka lënë të tjerët. Nuk është e vërtetë. Unë të nesërmen kam shkruar në Hogosht sepse kisha dëgjuar se më ishte vlarë babai. Ata kishin marrë urdhër për tërheqje, sepse forcat serbe kishin qenë shumë më shumë në numër se ne. T'i thuhet një njeriu tradhtar është punë shumë e madhe. Muhamet Pirraku duhet ta përmirësojë veten.

**PAQJA: Kur dhe pse ju burgosën?**

**Qahil Kajolli** - Më 14 gusht, 1945 një grup i madh prej bashkëluftëtarëve shkuan në Greqi. Midis tyre ishte axha im së bashku me Hysen Tërpezën. Balli filloi të dobësohet tej mase sepse këtij udhëtimit iu bashkëngjitën edhe bashkëluftëtarë të tjerë nga e gjithë Kosova, prej Drenice, Prizreni etj. Babai im Hajriz Kajolli, nuk u largua ndonëse unë isha i ri dhe e nuk dija mirë politikën, por ai nuk pranoi të shkonte jashtë Kosovës. Ai thoshte më mirë të vdes në vendin tim. Ne, një grup shumë i vogël prej njëzet, deri në njëzet e pesë luftëtar mbetëm në mal. Kështu ishte edhe me patriotin Abdyl Dura, ata ishin edhe më pak se ne. Mbetëm grupe shumë të vogla sa për të thënë që ekzistojmë. U martirizuan shumë prej tyre. Një herë mbetëm pa rroba. Babai kërkoi nga unë që të shkoja në Shkup për t'u takuar me udhëheqësit e NDSH-së. Unë në atë kohë isha 20 vjeç. Në Shkup hyra ilegalisht. Si i pa përvojë që isha bisedova me e

njërën prej dajave të mi Sali Dervishin, të më ndihmonte të takohesha me kryetarin e NDSH-së. Nuk më kishte shkruar ndërmend se daja mund të më spiunonte. Ai pasi kishte dezertuar nga mali, i ishte dorëzuar policisë, dhe kështu rashë në kurthin e tij. Si mos t'i besojta? Ai kishte ardhur në shtëpinë time, kishte biseduar me nënën time!?

**PAQJA: Si e përjetuat daljen nga burgu?**

**Qahil Kajolli** - Çdo gjë kishte ndryshuar, nuk kishim se çfarë të flisnim. Më shumë parapëlqyem heshtjen, se sa të iknim jashtë vendit ose të vetëvriteshim. Vetëvrasia është haram i madh.

**PAQJA: Cila është këshilla juaj për ne të rinjtë?**

**Qahil Kajolli** - Durimi duhet të jetë shoqëruesi ynë edhe për shumë kohë. Edhe pse në një të ardhme të afërt do të pavarësohemi, kjo nuk na zgjidh problemet dhe varfërinë. Ne nuk e kemi shkopin e Hazreti Musait. Ne të gjithë ta ndihmojmë duhet shtetin. Duhet të tolerojmë shumë, t'ia falim gabimet njëri tjetrit sepse të gjithë gabojmë. Prej qeveritarëve kërkoi sinqeritet, transparencë dhe ligje të hapura. Rinia duhet të mundohet të gjejë rrugëzgjdhje për jetesë në vendin e vet, dhe duhet ta punojnë tokën se toka jonë mund të na ushqejë edhe kaq sa jemi. Mos të mendojnë arratinë, sepse unë djemtë i kam në Zvicër, por prej tyre nuk pres asgjë. Ata janë drejt asimilimit, janë duke e humbur kulturën. Nipat dhe mbesat me mua flasin shumë mirë shqip, por midis vetes më lehtë merren vesh në gjuhën gjermane.

**Intervistoi  
Nexhati SPAHIU**



**Edhe në moshë të shtyer, nuk ndahet nga leximi!**

Dhuna në shkollat tona

# VESHJA PROVOKUESE E VAJZAVE NXITËSJA E SHERREVE

Ekzistojnë edhe disa faktorë që po ashtu shkaktojnë dhunë në një masë të madhe, ku futet edhe veshja ekstreme e vajzave.

Fitim VELIU

**D**huna në shkollat tona po shënon rritje çdo ditë, duke marrë përmasa të mëdha dhe po rrezikon jo vetëm sigurinë personale të çdo nxënësi, por edhe personelin arsimor në përgjithësi. Kjo dhunë pothuajse nuk ka të ndalur, sikur në vendin tonë të mos ekzistonte asnjë institucion legjitim që do të duhej të merrej me parandalimin e këtij fenomeni ekstrem shoqëror. Kur flasim për dhunën në shkollat tona, për rrezikun që i kanoset çdo nxënësi, madje siç e cekëm më lart, edhe vetë personelit arsimor, nuk hamendemi aspak se ky mund të jetë një virus i lindur tash pas luftës së fundit në Kosovë. Apo ndoshta dikush do të thoshte se kjo është si pasojë e mosfunksionimit të shtetit dhe rendit ligjor. Themi se dhuna ka ekzistuar nëpër shkollat tona edhe para lufte, por jo në këto përmasa aq të mëdha sa është sot. Themi se kjo dhunë ka një para-bazë vazhdimësie, por që ndoshta tash është e orientuar në një formë tjetër. Pra dhuna nuk është fenomen i ri, por mund të themi është vazhdimësi e një avazi të vjetër. Dhuna më herët ka ardhur nga faktorë të jashtëm, si p.sh.: nga huliganizmi, që ka qenë aktiv edhe në institucionet e tjera

më rëndësi jetike. Parandalimi i tij nuk ka mundur të bëhet, sepse vendi ynë ka qenë i kolonizuar kolektivisht dhe i paralizuar institucionalisht. Por tash dhuna vjen më shumë nga faktorët e brendshëm; pra dhuna vjen nga brenda vetë shkollës dhe institucionit të arsimit, i cili në vend se të merret me eliminimin e tij, i jep hov edhe më tepër. P. sh. nëse dikush nga nxënësit e lëndon dikë me ndonjë armë të ftohtë, ai nxënës largohet nga shkolla për një javë ose dy, dhe pastaj më intervenimin e ndonjë të njohuri, ai i kthehet përsëri normalitetit të mësimt. Ky është një fakt real që vetë drejtuesit e shkollave, kur kanë pasur ndonjë problem brenda shkollës së tyre, e kanë deklaruar këtë fakt edhe para mediave. Pra dhuna më herët ka qenë faktor i jashtëm i përkrahur nga administratat pushtuese, dhe ajo tash është konvertuar në faktorin e brendshëm, faktor që është shumë indiferent ndaj kësaj dukurie mjaft të rrezikshme për shoqërinë. Pra elementi i brendshëm është trashëgues i të jashtëmit me vetëdije apo pa të. Pra dhuna në shkollat tona po i ekspozon një rrezik permanent mbarë shoqërisë, sepse aty është e ardhmja. Por a duhet të rrimë indiferent ndaj këtij fenomeni të rrezikshëm shoqëror? Natyrisht se jo, sepse sot në vendin tonë ekzistojnë institucionet tona legjitime, si MASH-ti, drejtoria për arsim e komunës dhe organet e tjera

të sigurisë. Këto organe janë shumë indiferente, por ato duhet të lëvizin para se të bëhet vonë. Sidomos duhet të intervenohet në shkollat ku frekuentimi i nxënësve është shumë i madh dhe problemet janë më të shpeshta. Por të çudit fakti kur kjo dhunë vjen nga vendet të cilat konsiderohen si me të qytetëruara dhe me të zhvilluara ekonomikisht. Për këtë problem shoqëror, përgjegjësia bie mbi të gjithë ne, e sidomos mbi drejtuesit e institucioneve të dala nga vota e popullit. Por këto institucione po ikin përgjegjësisë, sidomos MASH-ti që përgjegjësitë për shkollat i ka transferuar tek drejtoritë për arsim. Por sa mund të jetë kjo efektive, kur këto drejtori nuk ka fuqi për të nxjerrë qoftë edhe një rregullore, kur dihet se sot në shumë shkolla nuk ka rregullore, dhe kjo e vështirëson tej mase procesin mësimor? Gjithashtu mungesa e kësaj rregulloreje prodhon edhe dhunë, sepse nxënësi mund të bëjë 100 mungesa e të mos përjashtohet. Kjo i jep atij pastaj mundësi të rebelohet, sepse ai e di se ndëshkimi është i pamundshëm, si pasojë e mosfunksionimit të rregullores. Ekzistojnë edhe disa faktorë që po ashtu prodhojnë dhunë në një masë të madhe, ku futet edhe faktori edukativ dhe faktori i veshjes ekstreme tek vajzat. Kur themi faktori edukativ mendojmë se nxënësit në shkollë nuk marrin edukatë, por vetëm një nxënie të dijes. Disa javë më para në emision: 'Jeta në Kosovë' në televizionin publik të RTK-së, ka qenë si temë referimi dhuna në shkollat tona. Aty ishin të ftuar përfaqësues të institucioneve të arsimit, të policisë për siguri dhe të nxënësve. Të gjithë nxënësit thonin se mungon marrja e edukatës në shkollë, kërkesë që haste në vesh të shurdhër nga të pranishmit në studio. Pra ata e kishin gjetur ilačin e kësaj sëmundjeje, sepse dhuna po qarkullon brenda normalitetit të jetës së tyre. Faktor tjetër është veshja ekstreme e vajzave, të cilat me provokimin e tyre ekstrem, krijojnë rivalitet tek nxënësit në shkollë. Pra u mbetet organeve përgjegjëse për arsim dhe siguri që t'i koordinojnë punët ndërmjet vete në eliminimin e këtij fenomeni të rrezikshëm shoqëror.



▶ Veshja ekstreme e vajzave, burim i dhunës nëpër shkolla!

Detyrat e shtetit ndaj fëmijëve

# FEMIJA, E ARDHMJA E BOTËS

Studimet tregojnë se fëmijët që kanë pësuar dhunë, ose që kanë qenë dëshmitarë të dhunës midis prindërve, shfaqin probleme emocionale të sjelljes. Ata kanë më pak shokë dhe marrin më pak pjesë në aktivitetet e organizuara jashtë shtëpisë së tyre. Ata mund të adaptojnë sjelljet e të rriturve duke dashur të mbrojnë nënat e tyre, ose mund të kenë sjellje agresive.



Arber ZEKA

S' do mend se fëmijët janë e ardhmja e botës. Duke marrë parasysh pasojat e luftës dhe shoqërinë, e cila është në zhvillim, si dhe duke u përpjekur ta ruajmë traditën në njërin anë, e në anën tjetër duke shikuar modernen, duhet të kemi parasysh se në Kosovë është prezent edhe një dukuri e cila nuk po trajtohet fare nga autoritet vendore, e ata janë fëmijët të cilët janë krenaria e shoqërisë. Të rinjtë nuk duhen harruar, ata janë ardhmëria jonë, prandaj është detyra jonë që të kujdesemi për ta. Ajo që të brengos, është pasqyra e cila reflektohet nëpër rrugët e kryeqytetit. Sipas një statistike jo zyrtare mësojmë se në Prishtinë fëmijët që ushtrojnë profesionin e lypsarëve është mbi dyqind, pastaj

ka prej tyre që merren si shitës ambulante dhe larës të xhamave të veturave, etj. Shumica e këtyre fëmijëve, shumica e të cilëve janë të pambrojtur, e kanë braktisur shkollën. S' do mend se këta rrezikojnë të bien pre e trafikimit dhe dukurive të tjera degjeneruese, që çdo ditë e më shumë fatkeqësisht janë duke u rritur në Kosovë. Fëmijët nën moshën 18 vjeçare, që punojnë me orar të plotë, ose të pjesshëm, nuk i kanë kushtet elementare të nevojshme në shtëpitë e tyre. Prindërit e tyre, për një arsye apo për një tjetër, nuk kanë mundësi t'ua sigurojnë kushtet për jetesë. Kështu, këta detyrohen të mbajnë barrën dhe ta sigurojnë veten dhe familjen me artikujt elementarë.

Nuk duhet të harrojmë se Kosova duhet të jetë një vend që duhet të ndër marrë masa efektive për parandalimin dhe zbatimin e shpejtë të ligjeve që do ta ndalonin këtë dukuri që tmerron. Andaj shtrohet pyetja se: Sa bëhet në këtë drejtim? Si të bëhen fëmijët të lumtur?

Të gjithë fëmijë kudo në botë, jët,

kanë të drejta të barabarta, ata janë të mbrojtur nga diskriminimi.

Duhet të kemi një strategji nacionale për të drejtat e fëmijës. Kjo është domosdoshmëri për arritjen e standardeve ndërkombëtare. Strategjia duhet të hartohet për periudhën 2007 – 2017, në përputhje me parimet e Bashkësisë Evropiane. Kjo strategji duhet të krijojë një SHOQËRI MIQËSORE për të gjithë fëmijët e Kosovës.

## Çpunë po bëjnë ata që obligohen?

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale drejtonte 31 qendra për mirëqenie sociale që u ndihmuan 1,188 jetimëve, 1,695 fëmijëve delikuent, 66 fëmijëve të abuzuar, 66 fëmijëve të braktisur, dhe 388 fëmijëve me probleme në sjellje.

Sipas një raporti të Fondit të OKB-së rreth 40 % e popullatës së Kosovës është nën moshën 18-vjeçare, dhe 33 % e popullatës është nën moshën 15-vjeçare. Rregulloret e UNMIK-ut gjithashtu ndalojnë punën e dhunshme apo të detyruar, përfshirë këtu punën e



Botohet nga O.J.Q. "Zëri Ynë"

## Redaksia

Drejtor: Muhamed Jusufi - KAJOLLI; Redaktor përgjegjës: Shkelzen NUZA; Redaktor gjuhësor: Mimoza SINANI; Redaktor Teknik/Grafika: Osman D. GASHI; Anëtarët e redaksisë: Arber ZEKA, Ilir DESKU, Nexhati SPAHIU, Mergim LUSHTAKU, Gëzim QERIMI; e-mail: revistapaqja@gmail.com, revistapaqja@hotmail.com, revistapaqja@yahoo.com; Adresa: Xhavit Mitrovica, nr. 14 përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë; Fusnotat e referencat e teksteve i mban redaksia. Kontakti: +377 44 418 935, +377 44 637 111, +377 44 633 281

fëmijëve. Megjithatë raportet tregojnë së një gjë e tillë është prezent në Kosovë. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me UNMIK-un, koordinon politika për mbrojtjen e fëmijëve, dhe Departamenti i Ministrisë për mirëqenie sociale është përgjegjës për ta siguruar mbrojtjen e fëmijëve. Ministria luan rol këshillëdhënës në vend të zbatuesit, dhe ka krye shumë pak inspektime gjatë këtij viti. Inspektime këto që do të mundësonin hartimin e shumë planeve për përmirësimin e gjendjes së fëmijëve kosovarë.

Numri i fëmijëve që punojnë në rrugë është në rritje e sipër, në krahasim me vitin 2005-06, ndonëse as UNMIK-u, e as Qeveria e Kosovës nuk mbajnë të dhëna. Andaj qeverisë së Kosovës ende i mungojnë planet për ta trajtuar këtë punë të rëndomtë të fëmijëve.

Rregulloret e UNMIK-ut e caktojnë moshën minimale për punësim në 16 vjet dhe në 18 vjet për cilëndo punë që mund ta rrezikojë shëndetin, sigurinë apo moralin e të rinjve, por lejojnë që fëmijët të punojnë në moshën 15-vjeçare, nëse puna e tillë nuk është e dëmshme për fëmijën apo nuk e pengon atë për ta ndjekur shkollën. Sipas studimeve të bëra nga Qendra për

Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve, konsiderohet se fëmijët më të rrezikuar janë: Fëmijët nga moshja 5 deri 18 vjeç. Fëmijët që vijnë nga familje me probleme sociale dhe të ardhura të ulëta. Fëmijët e lënë pas dore, ose të rritur pa kujdesin prindëror – fëmijët jetim. Fëmijët që vijnë nga familje në të cilat prindërit janë të punësuar jashtë shtetit. Fëmijë që punojnë ose shesin.

## Fëmijët jetimë janë fëmijë të veçantë.

"Bonjakët" të cilët njihen nga të gjithë ne, si fëmijë jetimë, vazhdojnë të mbeten ende pjesa më e prekur dhe e ekspozuar e problemeve ekonomike e sociale, si varfëria apo dhuna në vend. Sipas statistikave më të fundit të publikuara nga organizatat jo qeveritare, kjo shtresë e shqërisë nuk arrin standardet minimale. Problematike mbetet ende mungesa e një sistemi mbikëqyrës për neglizhencat, abuzimin dhe ushtrimin e dhunës ndaj këtyre fëmijëve.

Të gjithë e dimë se numri i personave të vdekur në Kosovë pas luftës nuk ishte i vogël. Kjo do të thotë se kemi shumë fëmijë që nuk kanë

askënd që përkujdeset për ardhmërinë e tyre. Prandaj qeveria duhet të ndërmarrë masa sa më shpejt që është e mundur që kjo shtresë të ketë mbështetjen e duhur. Gjatë vitit 2006, Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve në bashkëpunim me Ministrinë e Shërbimeve Publike kanë hartuar një projekt të përbashkët që do të ndihmonte jetën e jetimit kosovar. Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2006 parashihnin edhe rritjen e pensionit, ku një familje e dëshmorit do të marrë nga 175,5 euro në muaj. Por kjo a mjafton? Mbetet të shpresojmë sepse akoma nuk është bërë aprovimi i ligjit, i cili parasheh që pensioni duhet të jetë mbi 180%, mbi rogat mesatare të vendit tonë. Arsyeja se pse nuk realizohet i tërë ky projektligj thuhet se është mungesa e mjaftueshme e buxhetit. Por është premtuar se në 6 muajorin e dytë të vitit 2007, kur të bëhet edhe rishikimi i buxhetit, do të fillojë aplikimi i 100 % të projektit dhe ligjit për familjet e dëshmorëve. Gjithmonë aludohet në atë, nëse ka buxhet - thekson udhëheqësi i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Xhavit Jashari.

Kemi 2500 familje të dëshmorëve, prej tyre 40% e përbëjnë fëmijët jetim të moshave të ndryshme. Jetimë quhen të gjithë ata fëmijë që nuk i kanë të dy prindërit, ose njërin prej tyre – thekson Xhavit Jashari. Gjithashtu, ai thotë se angazhimi ynë me këtë lloj të fëmijëve është i vazhdueshëm. Ne kemi bërë aktivitete të ndryshme me shoqata të tjera. Po ashtu jemi ata që ju kemi bërë trysni institucioneve që këto të fundit të jenë nga ato që do të ndihmojnë ata që më së shumti kanë dhënë për këtë vend.

Sa u përket jetimëve do të sillja këtu thënien e kryetarit të Bashkësisë Islame z. Naim ef. Tërnavi i cili i porositi jetimët: "Ju fëmijëve jetimë, ju mbetet vetëm të mësoni, të silleni mirë midis vete. Ju mbetet që të jeni shembull për të tjerët në realizimin e amanetit të heronjve tanë, e baballarëve tuaj".

E përfundojmë duke shpresuar se gjendja e jetimëve, e posaçërisht e atyre që mbeten jetimë nga pasojat e luftës, do të rregullohet. Dhe me të vërtetë, brenga e vetme për ta të jetë se si të jenë shembull për shoqërinë.



► Një jetim duke lozur!

**Studimet tregojnë se fëmijët që kanë pësuar dhunë ose që kanë qenë dëshmitarë të dhunës midis prindërve, shfaqin probleme emocionale të sjelljes. Ata kanë më pak shokë dhe marrin më pak pjesë në aktivitetet e organizuara jashtë shtëpisë së tyre. Ata mund të adaptojnë sjelljet e të rriturve duke dashur të mbrojnë nënat e tyre, ose mund të kenë sjellje agresive.**

Post-modernia te shqiptarët

# SAKRIFIKOHET SHËNDETI PËR KULLERIZËM

Disa shqiptarë në Kosovë kanë të tatuuar në krahë shenjën “JNA” që d.m.th: Jugoslovenska Narodna Armija. Kur kjo armatë filloi t’i kthente shqiptarët në arkivole, personat e tatuuar, bënëin përpjekje të mëdha që të shlyenin atë simbol, madje edhe duke e hekurosur dhe djegur lëkurën, gjë që vërehej nga lëkura e dëmtuar me tatuazhin e mbetur në të.



Avni AVDIU

**T**ë gjitha mbrapshtitë e stilit që pretendohet të jetë në trend bartin edhe reperkusione shëndetësore. Lëkura nuk mbulohet vetëm me veshje, që më mirë është të quhet gjysmë- veshje.

Në të ndërhyhet edhe drejtpërdrejt përmes pirsingut dhe tatuazhit.

Në Kosovë në të gjitha vendet ku mund të hasësh argjendari, kryhet shpimi, që ndonjëherë mund të jetë edhe i rrezikshëm për shëndetin. Studiuesit paralamërojnë se pirsingu mund të shkaktojë probleme shëndetësore. Studimet në ditët e para pas shpimit të gjuhës kanë treguar se mund të arrihet deri te zhveshja e lëkurës, e cila vështirëson marrjen e ushqimit, gëlltitjen dhe foljen, ndërkohë që mund të dëmtohen edhe dhëmbët. Shumë mjekë janë shprehur se nuk i kuptojnë njerëzit se në çfarë gjendje mund të jenë përderisa vendosin ta shpojnë trupin në pjesë të ndryshme dhe nuk praktikojnë një kontroll mjekësor që do të ishte shumë më mirë për ta.

Mirëpo nuk ka aq rëndësi rreziku për shëndetin sa ka rëndësi ‘dukja e re’: shpim në hundë, në kërthizë, në buzë, në gjuhë, në vetull, e në shumë vende të veshit janë praktikat më të shpeshta të kësaj dukurie. Ndërhyrje tjetër direkt në lëkurë është edhe teknika e tatuazhit. Fjala tatu do të thotë gërvishje lëkure. Është diçka që e do me shpirt dhe e paraqet në trup.

Enes Baxhaku, mjeshtrë i tatuazhit në Kosovë, i cili edhe vetë e ka mbi 30% të trupit të tij me tatuazh, thekson se interesimi i të rinjve për tatuazhe është gjithnjë e në rritje. Dikush e do me shpirt ndonjë figurë dhe vendos ta paraqes në trupin e tij - thekson ai. Vetëm pas luftës kam pasur mbi 36.000 klientë. Sa

më përket mua - vazhdon ai, kur unë vendosi t’ua zgjedh figurat, bazohem në atë se çfarë karakteri është personi. Nëse personi është serioz, zgjedhja do të ishte ndonjë luan ose tigër që janë luftarakë dhe mund të paraqesin pak a shumë personalitetin e tyre. Nëse fjala është për rokera, atëherë zgjedhja kalon në kafka të ndryshme, satanizëm ose diçka të ngjashme. Nuk ka ndonjë dallim të madh në gjini. Meshkujt vend të preferuar për tatuazh e kanë krahun, ndërsa femrat pjesën e poshtme të belit, këmbën, barkun. Baxhaku pohon se mjetet e tatuazhit i ka sjellë nga teknologjia më e re që tani për tani praktikohet edhe në SHBA. Pra është e qartë se teknika e re sjell edhe sensin e ri, mënyrën e re të dukjes (lukut) dhe dëshirën për të demonstruar përpara të gjithëve faktin e të qenurit në trend. Tatuazhi në njëfarë mënyre ka filluar të përcjellë mesazhin e identitetit përmes shenjave. Ka raste kur tatuimet bëhen edhe fjalë ku shprehet simpatia ndaj ndonjë ekipi sportiv, ndaj ndonjë firme të njohur mode si: “Nike”, “Armani”, “Boss”, Joop etj, ndaj të dashurës, ndaj momenteve që lënë mbresa të pashlyera. Emrat e preferuar ndodh që

shkruhen me flokët e lëna qëllimshëm edhe në kokën e rruar tullac.

Në disa raste ndodh që personi, i cili ka tatuuar një simbol për arsye të ndryshme t’i dalë prej qejfit dhe të pendohet që ka bërë tatuimin e atij simboli. Më pas bëhen përpjekje të kota që dhunshëm të shlyhet tatuazhi tanimë i padëshiruar ose që mbi të të tatuohet ndonjë simbol tjetër. Gazeta e përditshme “Koha ditore”, e martë 22 gusht 2006, fq. 8 në shkrimin me titull: “Tatuazhet e një kohe të vdekur – damka që ende vret”, rrëfen se si disa shqiptarë në Kosovë kanë të tatuuar në krahë shenjën “JNA” që d.m.th: Jugoslovenska Narodna Armija. Kur kjo armatë filloi t’i kthente shqiptarët në arkivole, personat e tatuuar bënëin përpjekje të mëdha që të shlyenin atë simbol, madje edhe duke e hekurosur dhe djegur lëkurën, gjë që vërehej nga lëkura e dëmtuar me tatuazhin e mbetur në të.

Kështu me lëkurën e rrëgjuar bien edhe simbolet, idolet dhe idhujt e rremë një nga një, qoftë edhe duke shkaktuar vragë të pashlyeshme. Në këtë mënyrë çdo gjë është simuluar, kurse prej realitetit ka mbetur vetëm prezenca e nostalgjisë për të. Bodriari theksonte se pavarësi-



Vërja e tatusë përcillet me dhimbje!

mi i shenjës nga referencat, qartëson të gjitha rrëshqitjet dhe tendencat drejt hiper-realitetit. Me semiurgji ai nënkupton ndërhyrjen në shenjë, ridefinimin e shenjës dhe ripërcaktimin e saj e që do të thotë se edhe realiteti është vetëm një shenjë e asgjë më shumë.

Edhe bartja e veshjeve të shkurta të femrave nuk është pa pasoja për shëndetin. Fustanet dhe bluzat me shpinë të çelur, si dhe bluzat e shkurta deri te kërthiza, kryesorja 'janë' atraktive dhe 'u rrinë bukur' femrave, ndërsa për gjëra të tjera s'ka fort dert.

Shoqata e mjekëve britanikë ka publikuar një studim sipas të cilit këto veshje të shkurtra mund t'u shkaktojnë probleme serioze vajzave. Organet, sikurse vezoret dhe veshkat, janë të rrezikuara. Mund të ndodhë edhe infeksioni i organizmit dhe hipotermia. "Kur shoh studentet se si shëtisin me bark lakuriq, po kuptoj se ato hulumtimin nuk e kanë marrë fare seriozisht - është shprehur drejtoresha Katriona Logan.

Për të moshuarit kjo mund të quhet 'pispilosje', por për të rinjtë kjo prezanton mënyrën më të re të shfaqjes dhe stilin e risive që të mban në trend.

Përpos të veshurit, te të rinjtë ndryshime të mëdha ka pësuar edhe gjuha.

Gjithnjë e më e përdorshme është e ashtuquajtura 'gjuha e kullerizmit', e cila ka dalë si një lloj 'dialekti' rinor. Shprehjet 'kull bre njeri', 'op bre njeri', 'smut', 'trent', 'zanzi', 'xixë', 'fanki' etj. janë nocione që kanë pushtuar edhe mediat. Pra edhe pohimet dhe mohimet kanë ndryshuar: po=op dhe jo=ik bre njeri. Kjo pa mëdyshje imponon nevojën për sensibilizimin e vlerave të ndryshme. Se a duhet këto vlera të 'cool njeriut' ose 'cool kulturës' të pllakosin edhe gjeneratat më të reja, respektivisht fëmijët, kjo më nuk është çështje dëshire e ndokujt, por çështje kohe. Ashtu siç i janë lënë shumë gjëra stuhisë së kohës, po ashtu edhe kjo le të kalojë nëpër dhëmballët e këtij 'Kroni' që po përpin e gëlltit pa përtypte vlerat e dikurshme tradicionale dhe moderne.


Revista "Estrada" numër 5 e muajit maj 2005 është revistë për fëmijë. Kjo revistë është përplot me gjëra që nuk kanë të bëjnë aspak me fëmijët: si p.sh: prezentimi i rok grupeve, këngëtare me minifunde dhe veshje ekstravagande, fëmijë me tatuazh dhe love story të këngëtareve të huaja si Madona, Michael Jackson, Mariah Carey, etj.

Ekspozimi i këtyre gjërave për botën e fëmijëve është hap konkret drejt futjes

së tyre edhe në gjëra më intime dhe më të nxehta.

Gazeta "Kosova sot", e mërkurë 21 shtator 2005, fq. 1 dhe 8 sjell raportin me titull: "Seks në klasën e shtatë" ku thuhet se mjete kontraceptive (pilula dhe prezervativë) kërkojnë vajzat dhe djemtë edhe në klasën e shtatë. Raportuesja i referohet deklaratës së një farmacistesje të barnatores "Aspirin" në Prishtinë.

Në këtë mjegullnajë të formuar si e përhitur del edhe 'libido' frojdiane, e cila ngrihet pezull nga nënshtresa e trashë e mbuluar e nënvetëdijes, për të dalë mbi sipërfaqe më të theksuar të vetëdijes. Ndofta, thënë më mirë, ky formacion psikik vazhdimisht bën rrotullime, si ortek bore, ku s'dihet se kur e pavetëdijshmja e mund të vetëdijshmen dhe anasjelltas. Realiteti parësor i instinkteve dhe i së pavetëdijshmes (Frojdi) i ndihmuar tej mase nga teknologjia e re (TV, interneti, revistat, mjetet artificiale të kënaqjes: të ardhura në formë pilulash-Viagra dhe në formë organesh, madje deri te kukullat artificiale) doli si sublimim i shqisores, hiperbolizim i seksualitetit dhe në shumë raste edhe stërkeqje e shijes.



► Tatuja, dukuri në rritje e sipër në Kosovë!

Arsimi i Lartë në Kosovë

# NDËRTIMI I POLITIKAVE PËR ARSIMIN E LARTË NË KOSOVË

Arsimi i Lartë i Kosovës po shkon drejt përmirësimit dhe zhvillimit komfor me trendet dhe standardet e Procesit të Bolonjës, të cilat aplikohen në institucionet e arsimit të lartë në vendet e zhvilluara të Bashkimit Evropian.



**Bujar SEJDIU**

(4-6 QERSHOR 2007, MITROVICË)

**N**ë sallën e konferencave në Hotel Palace në Mitrovicë, gjatë 4, 5 dhe 6 Qershor u mbajt konferenca treditore e Grupit të Promotorëve të Bolonjës për hartimin e politikave për Integrimin e Kosovës në Zonën Evropiane të Arsimit Të Lartë. Organizuar nga KEC dhe MASHT ky takim ishte një vazhdimësi e radhës e punëve që janë duke u bërë nga Grupi i Promotorëve të Bolonjës në Kosovë. Kjo punëtori e radhës u mbajt si vazhdimësi e vizitave studimore nga Grupi i Promotorëve të Bolonjës në Universitetet partnere në këtë projekt të TEMPUS-it, në Universitetin e Lubjanës në Slloveni dhe në Universitetin e Peloponezit në Greqi, gjatë muajit dhjetor 2006, po ashtu punëtorja tjetër që u mbajt në Strugë në Janar të vitit 2007 ku morën pjesë ekspertët ndërkombëtarë nga Universitetet e lartpërmendura, si dhe ekspertë nga ESIB-i, si dhe Konferenca Ndërkombëtare e Arsimit të Lartë në Prishtinë që u organizua në mars të vitit 2007, në të cilën mori pjesë një strukturë e lartë ekspertësh vendorë dhe ndërkombëtarë për çështjet e arsimit të lartë.

Konferenca e fundit që u mbajt në Mitrovicë mbledhi një strukturë mjaft të larmishme duke përfshirë ekspertë ndërkombëtarë me renome dhe përvojë të gjerë në çështjet e Procesit të Bolonjës dhe të arsimit të lartë në përgjithësi, gjithashtu ekspertë vendorë nga MASHT-i, nga Universiteti

i Prishtinës, nga Qendra për Arsim e Kosovës, nga Universiteti Mbretëror ILIRIA, nga Agjencioni për Akreditim i Kosovës, nga Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave, si dhe studentë nga Parlamenti Studentor të cilët janë pala më e rëndësishme në tërë këtë proces.

Qëllimi i kësaj konference ishte ndërtimi i kapaciteteve për zhvillimin e politikave, si dhe zhvillimi i një apo më shumë politikave komfor me Procesin e Bolonjës, që duhet të zbatohet Arsimi i Lartë në Kosovë për të hyrë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. Organizatorët e konferencës duke u bazuar në konsultimet e mëhershme kishin vendosur që këtë konferencë ta ndajnë në dy pjesë: në pjesën seminarike, gjatë së cilës u mbajtën sesione plenare për aftësim në zhvillimin e politikave, si dhe në pjesën e punëtorive ku u bënë punë praktike në grupe për zhvillimin

e politikave.

Gjatë kësaj konference treditore grupet punuese zhvilluan dy politika dhe dy udhëzues bazë, të cilët do të shërbejnë si orientim për hartimin e draft politikave finale, në të cilat do të punohet gjatë verës nga grupet punuese në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë, të cilat do të shqyrtohen dhe diskutohen në seminarin e radhës që do të mbahet në shtator 2007, para se këto draft-politika t'i dorëzohen ministrit të arsimit për miratim.

Politikat dhe udhëzuesit që u nxorën si rezultat i punës në këtë konferencë u përcaktuan në katër pika kryesore:

- **Politika për zhvillimin e plan-programeve në arsimin e lartë** – Qëllimi i kësaj politike është sigurimi i një procesi koherent të hartimit të plan-programeve komfor me objektivat e Procesit të Bolonjës dhe me shembujt më të



Pamje nga sesionet plenare gjatë konferencës

mirë në rajon dhe Evropë. Kjo politikë do të ishte një mekanizëm lidhës ndërmjet aspekteve dhe faktorëve të ndryshëm të procesit të plan-programeve. Kjo politikë lë hapësirë dhe liri për respektimin e specifikave të fushave shkencore dhe departamenteve të ndryshme në procesin e hartimit të plan-programeve. Për shumë arsye, kjo politikë do të ndërtohet kryesisht në bazë të përvojave të mira të zbatimit të procesit 'tuning' në vendet e Bashkimit Evropian.

• **Udhëzues për ECTS** – Ky udhëzues hartohet me qëllim që të shërbejë si ndihmesë për mësimdhënësit dhe për Institucionet e Arsimit të Lartë për të siguruar koherencë më të madhe dhe qasje më sistematike në lidhjen e pikë-kredive me ngarkesën e punës së studentit dhe me rezultatet e nxënies.

• **Udhëzues për vlerësim të brendshëm në Institucionet e Arsimit të Lartë** – Synimi i këtij udhëzuesi është ndihmesa ndaj

pro- ces- it të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe në përpjekjet e tyre për sigurimin e cilësisë së shërbimeve të tyre akademike. Në këtë udhëzues do të

parashihen parimet, objektivat, procedurat kryesore si dhe bartësit përgjegjës për procesin e vetëvlerësimit në institucionet dhe njësitë akademike të arsimit të lartë në Kosovë.

• **Politika për krahasueshmërinë dhe njohjen e programeve të vjetra të studimeve dhe atyre të bazuara në Procesin e Bolonjës** – Qëllimi i kësaj politike është vendosja e parimeve, parametrave, procedurave dhe aktiviteteve për të siguruar krahasueshmërinë e ndërsjellë ndërmjet programeve të vjetra dhe të reja për të lehtësuar procedurat e përkatëse për përfituesit e ndryshëm për qëllime punësimi, për vazhdimin e studimeve apo për zhvillimin e karrierës.

Sigurisht që këto janë vetëm pika, në të cilat duhet bazuar hartimi i politikave për integrimin e Kosovës në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë, ndërsa draftet fillestare, që janë nxjerrë si rezultat i punës treditore në punëtoritë e kësaj konference, do t'i paraqesim në numrat e ardhshëm të revistës "PAQJA".



► Pamje gjatë punës në grupe

Mirësia në praktikë

# Fëmijët e fshatit Fortesë shkojnë për shërim në SHBA

**Naser Gashi babai i Arditit thotë “se kemi kërkuar ndihmë plot një vit e gjysmë nga të gjitha institucionet në Kosovë, nga Ministria e Shëndetësisë, nga organet e tjera qeveritare, nga biznesmenët kosovarë, por kërkesa ka rënë në vesh të shurdhër.**

**Bekim DOBRA**

**M**e 14 Dhjetor të vitit 2005 në fshatin Fortesë (ish Verbovc) të komunës së Drenasit në ditëlindjen e Krustem Gashit, ku ishin mbledhur shumë bashkëmoshatarë të tij, papritur shpërthen një bombol gazi, nga e cila dëmtohen 13 vetë, 11 prej tyre fëmijë. Pesë nga ta pësojnë djegie të rënda. Edhe pse u dërguan në Qendrën Emergjente në Prishtinë, shërimi i tyre nuk ka pasur sukses. Pas një viti e gjysmë djegie kryesisht në fytyrë, Arditi 11 vjeçar, Miloti 11, Ariola 10, Gonxhja 7 dhe Ariani 7 vjeçar, u nisën për shërim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të ndihmuar nga Zyra Amerikane në Prishtinë dhe KFOR-i.

Naser Gashi babai i Arditit thotë “se kemi kërkuar ndihmë plot një vit e gjysmë nga të gjitha institucionet në Kosovë, nga Ministria e Shëndetësisë, nga organet e tjera qeveritare, nga biznesmenët kosovarë, por kërkesa ka rënë në vesh të shurdhër. Më pas kemi kërkuar ndihmë nga Zyra Amerikane dhe KFOR-i, e ata posa i kanë parë fëmijët e djegur kanë pranuar t'i ndihmojnë, sepse që të pestë janë të djegur në fytyrë dhe një shërim i tillë mund të

bëhet vetëm në mjekësinë amerikane – shton Naser Gashi”.

Shërimi i tyre do të zgjasë nga një vit deri në tri vite. Operacionet kushtojnë shumë, dhe fatmirësisht ndihmësit (pra Zyra Amerikane dhe KFOR-i) kanë pranuar që përcjellës të fëmijëve të jenë edhe nënat e tyre. Sejdi Gashi shpreh se “nga të gjitha të këqijat, ndodhi edhe një e mirë, mundësia e shërimit të tyre, sepse unë nuk do të kisha mundur të ndihmoj në këtë rast. Djegia ka qenë shumë e madhe dhe në vende shumë të papërshtatshme për shërim.

Por doktorëve amerikanë ju dëshiroj suksese dhe më këtë rast shpreh falënderimet më të përzemërta për popullin amerikan e veçanërisht për Zyrën Amerikane në Prishtinë dhe KFOR-in në Kosovë”.

Nisja e fëmijëve për shërim në SHBA u përcoll nga shumë të pranishëm, nga bashkëmoshatarët e fëmijëve të shkollës së fshatit, nga mësimdhënësit e tyre, dhe nga qytetarë të tjerë. Nisja e tyre, me tre autobusë, për në Aeroportin e Prishtinës u bë nga Shkolla Fillore “Zenel Hajdini” në fshatin Fortesë.



Fëmijët në gjendje të këtyllë, kanë nevojë për shërim!

Shkurorëzimi, dikur dhe sot

# A NDIKOI EKSODI I FUNDIT NË DOBËSIMIN E FAMILJES SHQIPTARE

**Nga përjetimi i shpërbërjes së familjes gjatë luftës, ku shumë familjeve iu desh të strehoheshin në tenda apo në një ambient të përbashkët me shumë familjarë të huaj, de facto roli i kryefamiljarit në familje ra, ngase ishte e pamundur të ushtrohej ndonjë pushtet mbikëqyrës në një ambient të hapur siç ishte ai në tenda. Dhe rrjedhimisht kjo gjendje e shpërbërjes së familjes vazhdoi edhe pas luftës, ku liria e tepërt që ishte në ato rrethana krize, vazhdoi të dominojë edhe në rrethana paqeje.**

**Emine A. VEZAJ**

**S**i një fenomen historik njerëzor shpërbërja e familjes apo përfundimi i martesës, njësoj si edhe kontraktimi i saj, është i përhapur, i përsëritur dhe i larmë. Ekzistojnë me siguri po aq arsye për shkëputjen e martesës, aq sa edhe ato për kontraktimin e saj. Këto arsye janë të shumta dhe të llojllojshme, duke filluar që nga vdekja e paevitueshme e bashkëshort(es)it, ose shterpësia e padëshirueshme deri te gabimi i parëndësishëm i djegies së gjellës së burrit, apo futjes së kripës së tepërt në të, e mos të flasim për antipatinë arbitrare të burrit ndaj gruas së vet, apo të pëlqimit tekanoz të një gruaje tjetër, e cila atij i duket më e pëlqyeshme.

## Shkurorëzimi në histori

Jeta bashkëshortore nuk është fushë me lule. Bashkëshort i mirë është ai që duron shumë dhe që fal shumë. Edhe shkurorëzimi është pjesë e kësaj "fushe me lule". Si i tillë shkurorëzimi është

përmendur edhe në librat e shenjtë, mirëpo tek të gjithë është ligjësuar në mënyra dhe domethënie të ndryshme. Në të drejtën çifute, shkurorëzimi ishte i lejuar pa arsye. Çdokush që kishte dëshirë të martohej me ndonjë grua më të bukur, mund ta ndante gruan e tij. Megjithatë, arsyet e shkurorëzimit, çifutët i ndanin në dy grupe: grupi i parë, vlerësonte të metat trupore, p.sh të metat e saj në shikim, trupin e kërrusur, etj. Dhe grupi i dytë, vlerësonte të metat në moral. Në të drejtën e Egjiptit të Vjetër që njihet për respektin ndaj të drejtave të gruas, shkurorëzimi ndodhej nën autorizimin e burrit.... Vetëm pas pushtimit të Egjiptit, si rezultat i ndryshimeve në fushë të së drejtës, i ishte dhënë edhe gruas e drejta e shkurorëzimit, duke iu afruar, kështu, të drejtës greke. Sipas ligjeve të Hamurabit, e drejta e shkurorëzimit i përkiste burrit. Vetëm se grua, nga burri që e ndan, merrte një lloj pagese në monedhë ose në një formë tjetër. Kjo pagesë ndërronte në vartësi të asaj që grua e ndarë ishte me fëmijët apo jo. Sipas të

drejtës kineze, shkurorëzimi mund të realizohej me marrëveshje dhe pëlqim të dyanshëm. Në librat e shenjtë sipas Dhiatës së Vjetër, burri po pa diçka që nuk i pëlqen te njëra nga gratë me të cilat ishte i martuar, i bën shënim në letren e bardhë, ia jep dhe e përzë nga shtëpia. Dhe kjo grua, pasi të ketë dalë nga shtëpia e burrit të parë, mund t'i shkojë një mashkulli tjetër. Po qe se burri i dytë nuk e pëlqen, ia plotëson letren e bardhë, ia jep në dorë dhe e largon nga shtëpia e vet. Pas ardhjes së Dhiatës së Re, shkurorëzimi është i ndaluar në Krishterizëm. Vetëm shumica e dijetarëve protestantë, po qe se burri e braktis të shoqen për një kohë të gjatë, mundësinë e lejimit të ndarjes midis bashkëshortëve e mbron kështu: "Kurse të martuarave u urdhëroj, jo unë, por Zoti, që grua të mos ndahet nga burri, dhe në qoftë se ndahet, të mbetet e pamartuar, ose të pajtohet me burrin e saj. Dhe burri të mos e lërë gruan". (1 Korintasve, 7/10-11). Fenomeni i shkëputjes së martesës ka ekzistuar para Islamit dhe ka vazhduar që atëherë... Sidoqoftë, Islami ka marrë një qëndrim mesatar mes ndalimit kategorik dhe liberalizmit të pakualifikuar të shkurorëzimit. Islami as që e caktoi këtë praktikë, e as që e injoroi realitetin dhe paraqitjen e saj. P.sh., shkurorëzimi është i domosdoshëm aty ku nuk ekziston mënyrë e përfytyrueshme për pajtim ose shpresë për paqe ndërmjet palëve. Ai është mjaft i këshillueshëm apo madje edhe i obligueshëm po qe se grua është jo besnike, apo mospërfillëse, apo e pa vëmendshme ndaj detyrave të saj fetare. Është mjaft e padëshirueshme, apo madje edhe e ndaluar, që shkurorëzimi të bëhet në rastin kur nuk ka ndonjë arsye të vlefshme për të, për shkak se ai do të ishte i dëmshëm, ndërsa feja Islame ndalon që t'i shkaktohet dëm njëri tjetrit. Së fundi shkurorëzimi është i lejueshëm kur për të ka baza të shëndosha, por madje edhe



► **Edukimi i femrës, familja është më e fortë dhe më e shëndoshë!**

atëherë, Pejgamberi a.s. e ka cilësuar si 'gjëja më e urryer te Zoti, nga të gjitha gjërat e lejuara'. Edhe në të drejtën kanonike të shqiptarëve, burri ishte titullar i pushtetit në familje dhe në shoqëri, prandaj gëzonte një të drejtë të gjerë për të lëshuar dhe ndjekur gruan. Në përmbledhjen e Gjeçovit parashikohet se burri ka të drejtë për ta ndjekur gruan, "por s'a pru gruaja si duhet te burri", "për bracni a cubni" (KLD, fq. 20), mirëpo, kjo mundësi e tij ishte më e gjerë. Pra, burri kishte të drejtë të ndiqte gruan dhe të ndërpriste në mënyrë të vazhdueshme bashkëjetesën edhe për shkaqe më të imta, "mjafton me ia përbuzë fjalën e urdhrin", gjë që varej kryesisht prej tij. Pra, përgjithësisht në të gjitha legjislationet në histori, shkurorëzimi ishte drejtuar kundër gruas dhe e favorizonte burrin. Mirëpo në të drejtën islame një gjë e tillë lejohet në rrethana ekstreme, dhe prapë se prapë edhe pse konsiderohet si një lejim, ai njihet si një gjë e urryer te Zoti.

### Shkaqet e shkurorëzimit sot

Karakteristikë e shoqërisë shqiptare është fakti se ajo është familje e një sistemi të zgjeruar. Kështu çdo problem të cilin e ka përjetuar fëmija, familja e zgjeruar ka qenë ajo që çdoherë është ballafaquar me sfidën dhe me zgjidhjen e atij problemi. Janë shumë të rralla, apo nuk kanë ekzistuar fare rastet kur fëmija e ka zgjidhur problemin në mënyrë të pavarur. Ndërsa në periudhën në të cilën jemi duke kaluar, shumë gjëra kanë ndryshuar, duke filluar nga struktura e anëtarëve të familjes, dhe deri te zgjidhja e problemeve me të cilat ballafaqohemi sot. Çdo ditë, dhe para çdo situatë të rinjtë, marrin vendime në mënyrë të pavarur dhe pa marrë pëlqimin e asnjërit prind, pra si në kontraktimin e të fejuarës, ashtu edhe në shkurorëzimin e saj. Ata parapëlqejnë që çdo situatë të jetës së tyre ta kalojnë në mënyrë të pavarur. Por kjo nuk është e tëra. Një pjesë e të rinjve të influencuar nga sistemi kanonik i shqiptarëve, vendosin që të kontraktjnë martesën me pëlqimin e prindërve dhe vijnë deri edhe te mosnjohja e personit me të cilin do të ndajnë në të ardhmen të mirën dhe të keqen. Shtrohet pyetja, a thua kontraktimi i martesës është aq i padefinuar dhe seleksionuar në ligj dhe në fe, sa që kjo mbetet më shumë në rrethanat e kohës sesa në kodet e familjes...? Si në të drejtën laike, si në të drejtën e shariatit islam, kontrata e martesës është e shenjtë, dhe ajo para se gjithash duhet të lidhet në mënyrë të

lirë nga ana e bashkëshortëve të ardhshëm dhe pa imponimin e faktorëve të tjerë të jashtëm.

Në rrethanat aktuale, shkurorëzimi është bërë ndoshta tema më e përfolur nga të gjithë, duke pasur parasysh faktin e rrethanave para luftës së fundit, dhe atyre të pasluftës, ku shpërbërja e familjes ka marrë përmasa të mëdha. Siç kam përmendur edhe më lart, struktura e familjes shqiptare ishte e një sistemi të zgjeruar, dhe çdo problem zgjidhej në mënyrë të përbashkët, por gjithashtu edhe kontrata e fejesës lidhej me pëlqimin dhe miratimin e bashkëshortëve të ardhshëm, (çiftit të sapo kontraktuar). Femra mund të shkurorëzohej nga bashkëshorti i saj, vetëm nëse prekej nderi i bashkëshortit, siç është përmendur edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit, "të prekjes në sedër" (për çështje morale). Kurse kur kemi parasysh rrethanat aktuale në të cilat është duke kaluar shoqëria shqiptare, pra rrethanat e një shoqërie bashkëkohore, te shkurorëzimi mund të vihet më lehtë dhe në mënyrë më të shpejtë. Nëse më parë ka qenë një arsye që të shkohet deri te shkurorëzimi, si për hir të cenimit të moralit të burrit, apo për imponimin e martesës nga ana e prindërve, sot shkurorëzimi mund të kryhet për shkaqe të tjera më pak të rëndësishme. Si raste të vulltshme për të ardhur deri te shkurorëzimi, në rrethanat aktuale mund të përmendim: emancipimin i femrës, konkurrencën për një barazi të plotë gjinore, ndryshimin e strukturës së brendshme familjare, pavarësinë ekonomike të femrës, "kullerizmin" siç përmendet në trendet e kohës, mundësinë më të madhe për partner alternativ, praninë e ndërkombëtarëve, sidomos kopjimin e vlerave të tyre tradicionale, median, serialit, internetin, dhe deri te shterpësia që konsiderohet si një arsye konservative te shqiptarët, dhe që vazhdon edhe sot.

Shkurorëzimi e ka përcjellë çdo shoqëri në të gjitha fazat e zhvillimit të saj, mirëpo shkaqet që kanë çuar deri te kjo kanë ndryshuar sipas rrethanave dhe sipas kohës. Për sa kohë që te shqiptarët

institucioni i familjes ka funksionuar duke u mbështetur në rregullat e Kanunit të Lekë Dukagjinit, shpërbërja e familjes ka ndodhur atëherë kur është prekur morali. Ndërsa sot, shoqëria shqiptare, institucionin e familjes nuk e konsideron të shenjtë, dhe shkurorëzimi ndodh në rrethana shumë më pak të rëndësishme, nga ato që u përmendën më sipër. Nëse femra në të kaluarën është rritur dhe edukuar për t'i shërbyer burrit të saj, për të mbrojtur nderin dhe moralin e saj, sot ajo edukohet në mënyrë që të jetë e pavarur, që të ketë pushtet mbi burrin, të ketë pavarësim të plotë, të punojë, pra me një fjalë, të ketë emancipim të plotë në të gjitha sferat e jetës bashkëkohore. Por cili është faktori më dominues që e solli shoqërinë shqiptare deri te kjo gjendje? Padyshim është konflikti i fundit në Kosovë. Me përfundimin e luftës së fundit filluan të vërehen ndryshime të mëdha në të gjitha strukturat shoqërore. Menjëherë filluan të ndryshojnë raportet mashkull-femër, raportet prej kretë të familjes deri të anëtarit më i vogël në familje. Ndryshim thelbësor përjetoi kreu i familjes, pasi pushteti i tij në familje u zbeh. Nga përjetimi i shpërbërjes së familjes gjatë luftës, ku shumë familjeve iu desh të strehoheshin në tenda apo në një ambient të përbashkët me shumë familjarë të huaj, de facto roli i kryefamiljarit në familje ra, ngase ishte e pamundur të ushtrohej ndonjë pushtet mbikëqyrës në një ambient të hapur siç ishte ai në tenda. Dhe rrjedhimisht kjo gjendje e shpërbërjes së familjes vazhdoi edhe pas luftës, ku liria e tepërt që ishte në ato rrethana krize, vazhdoi të dominojë edhe në rrethana paqeje. Tashmë, me mbështetjen e administrimit të huaj, që lufton për pavarësimin e femrës, konsiderohet se ajo fitoi një pavarësim të plotë. Në çdo vend, ku ishte administrimi i huaj, për punë kërkoheshin zakonisht femrat, dhe nga kjo rezultoi që ajo të përjetojë një pavarësim të plotë ekonomik dhe social. Rrjedhimisht, ky emancipim i shpejtë i gruas nuk i shkoj shumë për shtat meshkujve, të cilët nuk ishin mësuar me një gjë të tillë më parë, dhe gradualisht nga kjo pozitë në të cilën u vendosë femra, filluan të lindin probleme të natyrave të ndryshme si: shthurja e familjes, rrënimi i vlerave tradicionale morale dhe deri te shkurorëzimi më i shpejtë. Kjo mund të jetë edhe një paradoks i kohës, mirëpo, realisht mund të mbetet i tillë, përderisa nuk përfillen rregullat morale të cilat kanë qenë dhe do të jenë gjithmonë mbrojtje nga të gjitha dukurit negative në kohë dhe në shoqëri të ndryshme.



**Shkurorëzimi, prishja e një familje.** ◀

Toleranca dhe kultura

# ROLI I ELITAVE FETARE NË TOLERANCËN RELIGJIOZE DHE KULTURORE

Natyrisht niveli infantil i paragjykimit të habit; natyrisht, paragjykime të tilla nuk mund të shqiptohen në instanca zyrtare, por një gjë është e ndjeshme, edhe pse e nëndheshme: shoqëria jonë i ndërton polet e perceptimit me të njëjtën teknologji të ideologjizuar komuniste si dje dhe kjo është një trysni që pavullnetshëm e bën njeriun të kompleksuar, të irrituar, jo të qetë, pasi në një mënyrë a në një tjetër, imazhi i tij duhet të përfshihet në një kornizë.

"TI BUJK, RUAJE PARMENDËN TËNDE,  
KURSE NE VENDOSIM, KUR TË QESË KALLI"  
JOSIF BRODSKI

Agron TUFA

**R**ipërtëritja e besimeve fetare nga hiri, fill pas rënies së komunizmit, ka patur po aq vështirësi sa kundër edhe ngritja e shtyllave të një shoqërie të lirë, civile e demokratike. Pas një përndjekjeje e gjenocidi të pashembullt që iu bë strukturës gjysmë patriarkale të shoqërisë shqiptare me përçarjen, nënshtrimin dheurvejimin e frikshëm totalitar, nëpërmjet luftës famëkeqe të klasave, për hir të kryeveprës së socializmit "njeriut të ri", u krijua përshtypja se besimi në Zot nuk kthen më në tokën e monstrave dhe se me "njeriun e ri" shpëlarja dukej një proces i përfunduar. Kështu kishte vendosur komunizmi. Por një sentencë popullore thotë: "njeriu vendos, Zoti zhvendos". Kështu dhe rimëkëmbja e ngrehinës së besimit nisi nga gërmadhat e saj, në një gjendje bankroti të theksuar teologjik e doktrinar dhe me një sfond psikologjik të paragjykuar e indiferent. Nëse sot ne mund të mburremi me fuqinë e madhe ndikuese të komuniteteve religjioze në shoqëri, kjo pa diskutim është vepra e atyre pri-jësve shpirtërorë që mbajtën një barrë

të madhe e të vështirë në lidhjet e humbura të njeriut me Zotin. Dhe hapja e shtigjeve gjithmonë, dihet, është po aq e rëndësishme sa dhe e atyre që i ftillojnë këto shtigje.

Megjithatë diskursi që më intereson në këtë kumtesë nuk ka të bëjë me dilemën "të jesh/të mos jesh", pasi ajo është tejkaluar me rënien e komunizmit; tani ajo ka të bëjë me një dilemë tjetër: "Si të jesh, duke mbetur vetvetja". Në situatën shoqërore post-komuniste jo gjithçka i sqaron ligji dhe kushtetuta demokratike, sepse rregullat dhe kushtetuta nuk mund të jenë "sendi në vetvete" jashtë një horizonti mental, social, politik, ideologjik dhe kulturor. Aq më tepër kur kemi të bëjmë me një receptim të rolit të fesë nga po ajo klasë që përbënte njeriun e ushqyer me mosbesimin, frikën, ambivalencën e identiteteve, rrjedhimisht me kontingjentin stereotip dërrmues të burokracive komuniste dhe mentalitetit komunist, mentaliteti i cili, i përkthyer në liritë e përditshmërisë demokratike shpalos ekuivoqe dhe nihilizma paradoksalë. Vetëdija e "njeriut të ri socialist" që është mësuar të arsyetojë me kategori polare që asgjësojnë njëra-tjetrën, përbën sfondin më të rrezikshëm për misionin paqësor të

fesë në shoqërinë tonë. Vazhdimisht, përkundër përsëritjes proverbiale se "tri besimet në Shqipëri janë faktorë të paqes dhe tolerancës", kemi patur keqkuptime, qoftë të pavetëdijshme e të pavullnetshme, qoftë strategji të tëra provokacioni, me qëllimin e mbrapshtë për të provokuar situata konfliktuale ndërmjet besimeve ortodokse, katolike e myslimane.

Meqenëse ligjëratat ime nuk do të merret hollësisht dhe me referenca të caktuara për në një gamë gjithëpërfshirëse faktesh, do të mjaftohem duke përmendur vetëm disa tipologji, tendenca dhe gjeste publike që ia vështirojnë fesë misionin e saj të paqes dhe tolerancës në shoqëri.

Kam dëshirë, më së pari, t'ia nis me një aspiratë ideologjike kuzale, të cilën njeriut tonë ia pëshpërit politika nga mëngjesi në darkë, pra një vektor drejt të cilit duhet të tentojë të përmbushet misioni historik i shqiptarëve, që është Evropa e bashkuar, alias BE. Vetvetiu njeriu nuk është i qetë, ndihet inferior, gjithmonë synimi mbetet larg, detyrat e shtëpisë që ngarkon BE përmbushen keq dhe pakënaqësia pushton shpirtrat e shqiptarëve, aq sa kjo sindromë kombëtare na jep një asi brengosje të atillë



► Kështu kishte vendosur komunizmi!

metafizike, mu si të ishte fjala për një vashë të pabukur, e cila me gjithë pispillosjet e saj, nuk po ia del dot të tërheqë vëmendjen e djemve të rinj: ata kalojnë indiferentë pranë saj, pa ia varur asnjë fije. Komplekset rriten dhe s'do mend, duhet gjetur shkaku, alibia, tersllëku. Është një proces psikologjik analog me arsyetimin komunist – një gjenealogji mendimi, e njëjtë me devizën "përpara deri në triumfin e plotë të komunizmit!" Por, gjithmonë, gjithmonë, në turravrapin tonë të çmendur e krejt të pasuksesshëm, ferrë nëpër këmbë na bëheshin klasat e përmbysura, kulakët, armiqtë e popullit që na sabotonin... me syrin e keq. Dhe armiku s'pushoi së shpikuri si alibi e përjetshme. Çfarë ka ndodhur në realitetin tonë të stërzgatur postkomunist? E njëjta gjë. Situata është shpërngulur: deviza "drejt komunizmit" si paradigmë ideologjike është zëvendësuar me devizën "para drejt BE". Dhe fakti që drejt BE po vonohemi, kjo do të thotë se ferrë nëpër këmbë na bëhem domosdo një armik sabotator, si ai i djeshmi në komunizëm (dhe po të ishte ndërmarrë kjo devizë gjatë komunizmit, me siguri armiku do të kishte qenë po ai). Veçse tani armiku i restauruar është pak si tjetër: ai shkon në xhami! Atij i është caktuar roli në paradigmen e re ideologjike, në ideologjizmin e ri. Besimtarët myslimanë kanë zëvendësuar klasat e përmbysura dhe së këndejmi ata janë kontigjenti i deklasuar!

Kështu na janë shpikur principe të reja, institucione të tëra të shoqërisë politike e civile, shoqata e individë mediatikë, të cilët, me llupë në dorë bëjnë me zell punën e gjurmuesit, kontestuesit, interpretuesit, derisa të shpallin përfundimisht "syrin e keq", "armikun e përbashkët të integritit tonë në Europë", pasi kanë zënë se, robi i Zotit ka marrë pjesë në një konferencë të vendeve islamike, shoqërohet me besimtarë myslimanë, përdor shprehje apo sentenca të profetit Muhamed a.s, apo thjesht, vishet me ndonjë rrobë jeshile. (Kjo e fundit më ka ngjarë personalisht gjatë një darke, për fat të keq, me njerëz të kulturës, duke u përqendruar gjatë gjithë darkës në aludimet e simbolikës së ngjyrës). Natyrisht niveli infantil i paragjykimit të habit; natyrisht, paragjykime të tilla nuk mund të shqiptohen në instanca zyrtare, por një gjë është e ndjeshme, edhe pse e nëndheshme: shoqëria jonë i ndërton polet e perceptimit me të njëjtën teknologji

të ideologjizuar komuniste si dje dhe kjo është një trysni që pavullnetshëm e bën njeriun të kompleksuar, të irrituar, jo të qetë, pasi në një mënyrë a në një tjetër, imazhi i tij duhet të përfshihet në një kornizë. Është një ndjeshmëri dhe kureshti perverse, me të cilën ose duhet të përballësh i kompleksuar, duke "zhdavaritur" mjegullat e paragjykimit dhe të demonstrosësh se je "polit-korrekt", ose t'i hysh një operacioni delikat e të rrezikshëm, duke shpjeguar, fjala vjen, që po, jam besimtar mysliman, siç janë 2/3 e popullsisë, por kjo nuk ka lidhje me alarmin

tënd hipotetik, se duke qenë i tillë, jam "armik" i supozuar i integritit tonë të mundshëm në BE.

Sfondi që konturova gjer më tash na jep dorë të meditojmë mbi një gjë thelbësore, atë se sa e vështirë është sot për besimtarin rishtar mysliman të hyjë në lidhje me besimin e tij në një tokë.

Kjo temë është lexuar më 26.05.2007, në simpoziumin e mbajtur në Tiranë me temë: "Domosdoshmërinë e Dialogut Ndërfetar e Ndërkulturor për Paqen Botërore".



**Xhamia, si monument historik, e jo si kult fetar!** ◀


Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

# Çështja e statusit të Kosovës ka hyrë në fazën finale

Presidenti amerikan George Bush gjatë vizitës së tij historike në Tiranë, ka deklaruar se SHBA-ja do ta njohë pavarësinë e Kosovës pavarësisht kundërshtimit të Serbisë dhe Rosisë.

Demir RESHITI

**K**osova ka qenë një nga temat kryesore në samitin e shtatë vendeve më të industrializuara të botës dhe Rosisë, që është mbajtur në Heiligen-damm të Gjermanisë. Pjesëmarrësit e këtij takimi nuk kanë arritur



Condoleezza Rice

marrëveshje për shtyrjen gjashtëmu-jore të zgjidhjes së statusit të Kosovës, të propozuar nga presidenti francez, Nikola Sarkozy.

Një ngjarje tjetër që duhet veçuar është deklarata e presidentit amerikan George Bush, gjatë vizitës së tij në Tiranë dhe në Sofje ku për herë të parë përmendi fjalën pavarësi për Kosovën. Ndaj kësaj deklarate të Bushit kanë reaguar Moska dhe Beogradi, ndërkohë që vendet tjera e kanë përshëndetur...

Në vazhdim po e paraqesim një përmbledhje të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, në periudhën 11 maj – 12 qershor 2007.

**(11 maj) Polt: Kosova e pavarur me qejf ose me zor**

**Beograd** - Kosova do të jetë e pavarur deri në verë, "me qejf ose me zor", ka deklaruar në një intervistë për radion beogradase "B 92", ambasadori amerikan në Beograd, Michael Polt.

**(13 maj) Rusia tregon dhëmbët**

**Moskë** - Rusia mund t'i vë veto draftit

të rezolutës së Këshillit të Sigurimit për Kosovën, ka thënë për televizionin rus "Vesti 24", ambasadori i Rosisë në OKB, Vitaly Churkin.

**(14 maj) Rice kërkon nga Rusia mbështetje për Kosovën**

**Moskë** - Sekretarja e amerikane e Shtetit, Condoleezza Rice, ka udhëtuar për një vizitë dyditëshe zyrtare në Moskë. Kosova ka qenë njëra ndër çështjet kryesore që ajo ka biseduar me presidentin rus Vladimir Putin dhe shefin e diplomacisë ruse, Sergej Lavrov.

**(15 maj) Rice: Kosova kurrë më pjesë e Serbisë**

**Moskë** - Kosova asnjëherë më nuk do të jetë pjesë e Serbisë pasi që kjo do të ishte e pamundur, ka deklaruar sekretarja amerikane e Shtetit Condoleezza Rice, në një intervistë ekskluzive për radion moskovite "Ekho Moskvy".

**(16 maj) Ban Ki Moon: KS ta miratojë rezolutën sa më shpejt**



Ban Ki Moon

**Nju Jork** - "Shpresoj se Këshilli i Sigurimit do të miratojë rezolutën sa më shpejt që të jetë e mundur dhe unë i bëj thirrje që ta bëjë këtë", ka thënë kreu i OKB-së, Ban Ki-Moon, në një intervistë për gazetën belge "La libre Belgique".

**(17 maj) Rehn: BE-ja angazhohet për zgjidhje të qëndrueshme**

**Beograd** - Komisionari evropian për zgjerim, Oli Rehn, ka deklaruar se zgjidhja e statusit të Kosovës dhe procesi i aderimit të Serbisë drejt BE-së janë procese të ndryshme që duhet të mbeten të veçura.

**(18 maj) Wordsworth: Nuk presim që Rusia të vërë veto**

**Beograd** - Rusia nuk ka ndonjë interes të veçantë që të vërë veto në rezolutën për pavarësinë e Kosovës sepse, këtë propozim e mbështesin shumica e anëtarëve të Këshillit të Sigurimit, ka thënë për agjencinë Beta, ambasadori i Britanisë së Madhe në Serbi, Stephen Wordsworth.

**(20 maj) Bush dhe Scheffer bisedojnë për Kosovën**

**Uashington** - Në Kraford të Teksasit, është zhvilluar një takim me dyer të mbyllura ndërmjet presidentit amerikan, George Bush dhe sekretarit të përgjithshëm i NATO-s, Jaap de Hoop Scheffer, në të cilin është diskutuar për Kosovën.

**(22 maj) Scheffer mbështet propozimin e Ahtisaarit**

**Nju Jork** - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s Jaap De Hoop Scheffer pas takimit me presidentin e SHBA-së, George Bush, ka deklaruar se e mbështet fuqishëm propozimin e Martti Ahtisaarit që Kosova të bëhet e pavarur.

**(23 maj) McCormack: Planit të Ahtisaarit mund t'i bëhen modifikime**

**Uashington** - Zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, Sean McCormack, ka deklaruar se propozimit të Ahtisaarit mund t'i bëhen disa modifikime.

**(24 maj) D'Alema: Pavarësia e Kosovës është e pashmangshme**



Olli Rehn

**Bari** - Shefi i diplomacisë italiane Massimo D'Alema gjatë një takimi me gazetarë në qytetin italian, Bari ka thë-

në se pavarësia e Kosovës është e pashmangshme

**(28 maj) NATO miraton rezolutë për Kosovën**

**Madeira (Portugali)** - Asambleja Parlamentare e NATO-s, ka miratuar një Rezolutë në mbështetje të planit të Ahtisaarit për Kosovën.

**(29 maj) Ministrat e BE-së bisedojnë për Kosovën me homologët nga Azia**

**Hamburg** – Statusi i Kosovës, ka qenë njëra nga temat që është diskutuar në takimin e ministrave të Jashtëm të Bashkimit Evropian me homologët e tyre nga Azia, që është mbajtur në Hamburg të Gjermanisë. BE-ja ka shfaqur shpresën se Kina dhe Indonezia do të shfaqin bashkëpunim më të mirë, duke e mbështetur rezolutën e Këshillit të Sigurimit për pavarësinë e mbikëqyrtur të Kosovës.

**(30 maj) Përplasje SHBA-Rusi lidhur me statusin e Kosovës**

**Postdam** - Rusia dhe SHBA-ja janë përplasur sërish rreth të ardhmes së Kosovës në takimin e ministrave të jashtëm të 7 vendeve më të industrializuara të botës plus Rusinë, që është zhvilluar në Postdam të Gjermanisë. Sipas njoftimeve të agjencive, që thirren në burime brenda takimit, Rusia edhe në këtë takim ka hedhur poshtë propozimin e OKB-së për Kosovën, përkundër kërkesës së ministrit të jashtëm gjerman Frank-Walter Steinmeier që Kremlinin të mos e pengojë përcaktimin e statusit të Kosovës.

**(31 maj) Rice: Kosova kurrë më në përbërje të Serbisë**

**Potsdam** – Sekretarja amerikane e shtetit Condoleezza Rice, në përmbyllje të takimit të G8-s, në Potsdam të Gjermanisë, ka deklaruar se SHBA-ja mbështet planin e Ahtisaarit i cili parasheh pavarësi të mbikëqyrtur për Kosovën.

**(1 qershor) Bush: Statusi sipas planit të**



**Jaap de Hoop Scheffer**

**Ahtisaarit**

**Tiranë** – “Plani i paraqitur nga zoti Ahtisaari, është rruga e drejtë dhe e vetme për të ecur përpara”, ka deklaruar kryetari amerikan George Bush në një

intervistë për kanalin televiziv të Tiranës “Vizion Plus”.

**(3 qershor) Halonen: Finlanda përkras pavarësinë e Kosovës**

**Helsinki** - Finlanda mbështet planin e Martti Ahtisaarit për pavarësi të mbikëqyrtur për Kosovën, ka deklaruar presidentja e Finlandës, Tarja Halonen në Helsinki pas takimit me homologun e saj serb, Boris Tadiq.

**(5 qershor) Pierce: Janë të sigurt 9 votat e nevojshme për Rezolutën**

**Londër** - Zëvendës-shefja e misionit britanik në OKB, Karen Pierce, ka vlerësuar se, nëse rezoluta për Kosovën nuk kalon në Këshillin e Sigurimit të OKB-së para samitit të G8-s, atëherë Kosova do të jetë në agjendën e këtij takimi.

**(6 qershor) Bush dhe Putin nuk gjejnë gjuhë të përbashkët për Kosovën**

**Heiligendamm** - Presidenti i SHBA-së, George Bush, ka deklaruar se nuk ka gjetur gjuhën e përbashkët me homologun e tij rus, Putin, për mënyrën e zgjidhjes së statusit të Kosovës. Bush i ka bërë këto deklarata pas takimit me Putinin në takimin e G8-s në Heiligendamm të Gjermanisë.

**(8 qershor) G-8 pa marrëveshje për Ko-**



**Vladimir Putin**

**sovën**

**Heiligendamm** - Shtatë vendet më të industrializuara të botës dhe Rusia, nuk kanë arritur marrëveshje për shtyrjen e procesit të zgjidhjes së statusit të Kosovës, në samitin e G8-s, në Heiligendamm të Gjermanisë.


Propozimi i presidentit francez, Nikola Sarkozy, për shtyrje gjashtëmujore të zgjidhjes së statusit, nuk është miratuar në takim. Deklarata në formë të shkruar, me të cilën vendet perëndimore do të pajtoheshin me shtyrjen e zgjidhjes së statusit të Kosovës për gjashtë muajt e

ardhshëm, nëse Rusia pranon që rezultati përfundimtar do të ishte pavarësia e Kosovës, në rast të mosgjetjes së një zgjidhjeje tjetër, nuk është nënshkruar nga pjesëmarrësit e samitit.

**(10 qershor) Bush: ShBA-ja do ta njoh pavarësinë e Kosovës**

**Tiranë** – Presidenti amerikan George Bush gjatë vizitës së tij historike në Tiranë, ka deklaruar se ShBA-ja do ta njohë pavarësinë e Kosovës pavarësisht kundërshtimit të Serbisë dhe Rusisë.

**(11 qershor) Ban Ki Moon: Rezoluta të**



**George Bush**

**miratohet sa më shpejt**

**Nju Jork** - Sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-Moon, ka deklaruar se është e domosdoshme që Këshilli i Sigurimit të marrë një vendim dhe të bëjë një gjykim të drejt duke miratuar dhe mbështetur rekomandimin e Ahtisaarit, sipas të cilit Kosova do të fitojë pavarësi me mbikëqyrje ndërkombëtare.

**(12 qershor) GK (pa Rusinë) konfirmon mbështetjen për planin e Ahtisaarit**

**Paris** – Drejtorët politikë të vendeve anëtare të Grupit të Kontaktit, kanë konfirmuar në Paris, qëndrimin e tyre që të arrihet sa më shpejt deri te rezoluta për Kosovën në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Në një njoftim zyrtar të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Francës pas përfundimit të takimit, është theksuar se “përfaqësuesit e Gjermanisë, SHBA-së, Francës, Italisë dhe Britanisë së Madhe e kanë konfirmuar dëshirën e tyre që pa shtyrje të mëtejshme të vazhdohen bisedimet në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, në mënyrë që të arrihet deri te rezoluta e cila do të mundësojë zbatimin e propozimit të Martti Ahtisaarit”. Në takim nuk ka marrë pjesë përfaqësuesi i Rusisë.

Krimet serbe dhe Drenica

# SERBIA (S)I KA HARRUAR TË BËRAT E SAJ NË KOSOVË

Ashtu si moshja e një rrapi madhështor që përcaktohet nga rrathët e trungut të tij, edhe dhimbja e një kombi mund të përcaktohet nga të rënët e tij. Këta të rënë për idealin e lartë kombëtar, assesi nuk vdesin, nuk humbasin në muzgjet e harresës.



Osman D. GASHI

**H**istorikisht dihet që Drenica ka qenë një halë në sy për Serbinë për shkak të rezistencës së vazhdueshme të saj. Dihen mirë historitë e Azem e Shotë Galicës, pastaj më vonë edhe të Shaban Polluzhës, e së fundi, e atij që vendosi themelet e historisë moderne të Kosovës, të komandantit legjendar, Adem Jasharit dhe familjes së tij. Në këtë numër do të paraqesim shumë shkurt disa krime barbare të ushtrisë së rregullt, militare dhe asaj paramilitare të Serbisë ndaj popullatës civile e të pambrojtur shqiptare në Drenicë.

## Masakra në Abri-në e Poshtme

Tetëmbëdhjetë anëtarët e familjes Delijaj të vrarë në Abri-në e Poshtme, të cilin ishin strehuar në një pyll të Drenicës pasi fshati i tyre ishte goditur me granata gjatë ofensivës serbe në këtë fshat.



Familja Delijaj po strehohej në këtë tendë të improvizuar me 18 anëtarë të saj, të cilët u vranë nga ushtria serbe. Trupat e masakruara të Pajazit Delijajt, gjashtëdhjetë e pesë vjeç dhe Have Delijajt, gjashtëdhjetë e tre vjeç, janë gjetur në këtë tendë.



Trupat e Gentiana dhe Donjeta Delijaj, shtatë dhe pesë vjet të reja, janë hequr nga grupi i masakrës në një pyll afër fshatit Abri e Poshtme, masakër në të cilën janë masakruar tetëmbëdhjetë anëtarë të familjes Deliaj.



Valmira Deliaj, një foshnjë tetëmbëdhjetë muajsh, është gjetur e vdekur në masakrën e fshatit Abri e Poshtme. Ajo pjesërisht është e mbuluar nga trupi i nënës së saj, Mejhare Delijaj, njëzet e shtatë vjeçare, e cila ka vdekur nga plaga e marrë nga një e goditur me automatik në kokë.

## Baladë për Valmirën e vogël

“Valmira Delijaj, 18 muajshe, veshur me xhup roze, me kapuçin ende në kokë; fytyrën gjithë gjak. Në qafë i varej biberoni. Pranë – shishja me qumësht.” – sipas gazetarit të Uashington post” , Din Moor.

*Valmira me xhupin ngjyrë rozë, faqet – vishnjë Valmira, o bec që pinë qumësht, fytyrë prerë Valmira, me buzët në biberonin e bukur si engjell rrëzuar me shigjetë, fytyrë prerë.*

*Valmira, përse ke ndenjur te shkurret?  
Përse nuk u bërë e madhe menjëherë  
Ta merrje te doçka një pushkë të madhe  
të shkoje ushtarë me fytyrë e prerë?*

*Valmira, o qumësht, ç'ke bërë që të mbytën?  
O zogu i mamit të vdekur kaq pranë  
Po mami për ty s'do të ngrihet me natën  
e ti me buzë s'do ta puthesh babanë.*

*Po këtë trikon rozë, moj, mami ta veshi  
që të thonin të gjithë “sa kukull e bukur”?  
Që mami të tërhiqte mënjandë duke qeshur  
kur të sulleshin si qenushë për të të puthur?*

*Kush është ai burrë të të marrë, Valmira  
me krahë përbindëshi të të vërë në qivur?  
I duhet të flakë tej zemrën mbi Shkëlzen  
mes lotësh në vend të saj të vejë gurë.*

*Valmira, mes pyllit, sikur të kish gjetur  
ashtu, duke fjetur, me biberonin në gojë  
edhe ditë, edhe javë të kishte pa ngrënë  
s'të ushqente, por nënë do të bëhej ulkonja.*

*Kush ishte kjo qenie që s'të la, moj Valmira  
ta pije tërë qumështin, e vraftë Perëndia!  
- Ai që ka mbytur nëpër gjak të Kosovës  
dhe njëzet njerëz njëherësh nga familja Delia.*



Fshatarët e fshatit Abri e Poshtme, varrosin tetëmbëdhjetë anëtarët e familjes Delijaj të masakruar në pyllin afër fshatit.

**Golubovc – ekzekutohen 13 shqiptarë të pafajshëm**



Një fshatar duke shikuar tokën e gjakosur ku janë ekzekutuar 13 burra shqiptarë etnikë në Golubovc, më 26 Shtator 1998.



Gëzhojat e harxhuara prej mitralozit M48 të përdorura nga policia serbe në ekzekutimin e 13 shqiptarëve etnikë në Golubovc.

## Masakra në Abri-në e Epërme



Trupi i Ali Koludrës, gjashtëdhjetë e dy vjeç, është gjetur me një vrimë të shpuar nga plumbi në ballë. Është gjetur i vdekur në një fushë të hapur në fshatin Abri e Epërme, ende duke e mbajtur në dorë shkopin në të cilin mbështetej. Gruaja e tij është gjetur e vrarë disa metra larg tij.



Pesëdhjetë vjeçarja, Hyra Koludra, gruaja e Aliut, po ashtu e gjetur e vrarë nga forcat agresore serbe në fushë të hapur në fshatin Abri e Epërme.



Kjo shtëpi, si shumë të tjera në fshatin Abri e Epërme është plaçkitur dhe djegur nga forcat serbe pasi pronari i shtëpisë është larguar prej shtëpisë. Shtëpia nuk tregon shenja të dëmtimit me plumba apo granata, duke na sugjeruar se ajo është shkatërruar dhe djegur nga afër.

## Kishnareka – vendbanimi i refugjatëve



Fshatarët e Kishnarekës, kanë ndërtuar këto tenda me plastmasë, menjëherë pasi janë larguar forcat serbe.



Fëmijët mbajnë një gëzhojë 100 mm që forcat serbe e kanë përdorur për të shkatërruar një fshat afër Kishnarekës.



Autoritetet serbe kanë lëshuar nga ajri trakte për banorët që kanë qenë në kampin e Kishnarekës, duke iu thënë se jeni të sigurt të ktheheni në shtëpi. Disa iu kanë besuar këtyre premtimeve të rrejshme dhe janë kthyer, në vend që të qëndronin në pyll.

Këto përkrahje të shkurtra ishin një numër fare i vogël i kasaphanës të Serbisë në rajonin e Drenicës. E mos të harrojmë se forcat militare, paramilitare, ushtarake e ato policore kanë shkaktuar krime dhe masakra në tërë territorin e Kosovës, duke shkaktuar një tragjedi në fund të shekullit XX, dhe duke tronditur tërë botën me ato që ndodhën në Kosovë.

Dialogu ndërftetar

# Domosdoshmëria e dialogut fetar dhe ndërkulturor për stabilitetin në Ballkan

Mbas 11 shtatorit flitet për përplasje kulturash dhe civilizimesh dhe kuptohet që mungesa e dialogut do të prodhojë pashmangshmërisht përplasje kulturash. Kjo sepse përplasja e civilizimeve është produkt i mendësisë së kultura e një grupi shoqëror është superior karshi grupit tjetër. Dhe natyrshëm kjo ndjenjë superioriteti e ndërsjellë lind nga vakumi që krijohet nga mungesa e dialogut. Dialogu ndërkulturor apo ndërftetar nënkupton një proces, një seri aktivitete që përsëriten për të krijuar shërbime, që në rastin tonë këto shërbime nënkuptojnë një shoqëri ballkanike më shumë të sigurt, më shumë të stabilizuar dhe më shumë të integruar.

Ferdinand XHAFERAJ

**M**e fillimin e mijëvjeçarit të ri shoqëria botërore, dhe për rrjedhojë edhe ajo ballkanike, po ndeshet me një sfidë të re: atë të globalizmit. Globalizmi natyrshëm është konceptuar edhe si mundësi për përfitime, por edhe si kërcënime dhe kjo varet nga specifikat e vendeve të veçanta dhe nga reagimi i vet shoqërive të këtyre vendeve të veçanta dhe nga reagimi i vet shoqërive të këtyre vendeve karshi sfidës

së globalizmit. Kuptohet që globalizmi prek shumë aspekte që janë ekonomike, politike, ushtarake, kulturore dhe fetare. Por, unë do të kufizohem vetëm në aspektin kulturor dhe fetar, sepse bëhet fjalë për një rajon si Ballkani, që është shumë kompleks nga pikëpamja etnike, kulturore dhe fetare.

Në referatin tim të shkruar unë do të përpiqem të bashkoj dhe të shikoj efektin shkak-pasojë midis dy çështjeve shumë sensitive që janë: nga njëra ana dialogu ndërkulturor dhe ndërftetar, dhe nga ana tjetër ndikimi i tyre i drejtpërdrejtë në stabilitetin e qëndrueshëm në rajon.

Duke e parë stabilitetin në rajon të lidhur ngushtë me rëndësinë e dialogut ndërkulturor dhe ndërftetar unë bie dakord me konsideratën se rajoni ka lënë mbrapa konfliktet e formësuara nga nacionalizmi ekstrem. Kjo nuk do të thotë se nuk ka dhe nuk pranoj mendime të kundërta, por mendohet se mbas 11 shtatorit tendencat e reja globale parashtrajnë se stabiliteti i rajonit mund të kërcënohet nga konfliktet me prapavijë fetare apo kulturore.

Në mbështetje të kësaj teze që sapo ekzpozova unë do të lëviz në fjalën time në tri pista:

- ne fillim do të parashtrij përcaktimin normativ se konfliktet në Ballkan nuk janë formësuar për arsye fetare, apo feja nuk ka qenë burim parësor konflikti në rajon, dhe do të përpiqem të argumentoj edhe arsyet përkatëse. Mbas këtij këndvështrimi të shkurtër historik unë do të argumentoj edhe
- rëndësinë e dialogut ndërkulturor dhe ndërftetar si domosdoshmëri për stabilitetin e rajonit.
- Dhe së fundi do të përfundoj me konkluzionet.

**1. Konfliktet në Ballkan nuk janë formësuar për arsye fetare apo feja nuk ka qenë burim parësor konflikti.**

**Cilat kanë qenë shkaqet e konfliktit në Ballkan?**

Ballkani është formuar nga një histori unike. Si asnjë pjesë tjetër e kontinentit ai është sunduar për dy mijëvjeçarë nga një seri perandorish shumë-etnike. Fuqitë e mëdha të së kaluarës: romakët, turqit, austriakët, gjermanët, francezët dhe britanikët, të gjithë së bashku kanë dominuar apo kërkuar të dominojnë në këtë rajon. Perandoritë multi-etnike gjeneruan një mozaik të gjerë popujsh, gjuhësh, besimesh dhe kulturash në rajon. Karakteristika përfshirëse e të gjithë vendeve të Ballkanit është fakti se ato janë shtete fqinje, nga ku edhe këto minoritete kanë ardhur. Pra, Ballkani është



► Globalizmi, sfida e mijëvjeçarit!

vendi ku bashkëjetojnë rreth 20 popuj të cilët flasin gjuhë të shumta dhe praktikojnë tri fe kryesore: katolicizmin, ortodoksizmin dhe islamin.

Por, secili nga shtetet e Ballkanit ka periudhën e vet të lavdisë, që përputhet me pushtimin maksimal të territorit. Këto zgjerime territori erdhën përmes luftërave apo si shpërblime të fuqive të mëdha dhe kanë ndodhur në periudha të ndryshme historike. Kështu, shqiptarët përjetuan prosperitetin e madh gjatë kohëve romake. Përparimi i sllavëve i preku thellë tokat shqiptare. Maqedonasit njohin dhe kujtojnë si kohët e lavdisë të tyre ato të Filipit të II dhe Aleksandrit të III (periudha para mesjetare), ku mbretëria maqedonase u shtri deri në Persi dhe Mesdhe. Bullgarët kanë parë me interes perandorinë e car Dushanit (shek. XIV), kur Serbia përfshiu pjesë të Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Greqisë veriore.

Përmbledhja e mësipërme historike tregon qartë se pjesa më e madhe e kombeve në rajon kanë konkluduar dhe pretenduar një territor të përzier dhe këtu qëndron shkak qendror i konflikteve të përhershme.

Sikurse edhe analizuam, feja në vetvete nuk ka qenë shkak parësor në konfliktet e vazhdueshme në Ballkan. Por, edhe pse Ballkani nuk ka përjetuar asnjëherë llojin e luftërave fetare të zhvilluara në Evropën qendrore dhe Perëndimore, feja sidoqoftë luajti një rol të konsiderueshëm në konfliktet etnike. Tendencat për të identifikuar lidhjet e ngushta fetare me një grup specifik etnik dhe liria realtive e Perandorisë Osmane u kombinuan për t'i bërë kishat lokale si simbole qendrore të formësimit të nacionalizmit brenda Ballkanit. Kështu, Kisha Latine nuk ishte vetëm një pikë grumbullimi ku formësohej nacionalizmi kroat kundër serbëve. Po kështu islamizmi i popullatës islame ishte një faktor mjaft i rëndësishëm për t'iu shmangur presionit asimilues. Shqiptarët midis të tjerave përqafulan fenë islame edhe për të ruajtur identitetin e tyre kombëtar.

## 2. Domosdoshmëria e dialogut ndërkulturor dhe ndërftetar si garantues i stabilitetit për të tashmen dhe të ardhmen e rajonit.

Rajoni duket se ka lënë mbrapa nacionalizmin ekstrem dhe dëshira e popujve të Ballkanit është t'i bashkëngjiten Evropës. Kështu, Maqedoni është një hap përpara Shqipërisë në procesin e integritimit Evropian, ndërsa Shqipëria një vit më parë nënshkroi MSA. Serbia, po kështu, ka shprehur vullnetin për anëtarësim në BE. Pra, qytetarët në Ballkan duket se kanë dëshirë të jetojnë në paqe dhe nga këtu buron rëndësia e dialogut ndërftetar dhe ndërkulturor për ta



Dialogojnë, derisa presin të falin namazin!

mbajtur rajonin larg konflikteve me prapavijë fetare që mund të ekspozohen.

Mbas 11 shtatorit flitet për përplasje kulturash dhe civilizimesh dhe kuptohet që mungesa e dialogut do të prodhojë pashmangshmërisht përplasje kulturash. Kjo sepse përplasja e civilizimeve është produkt i mendësisë se kultura e një grupi shoqëror është superior karshi grupit tjetër. Dhe natyrshëm kjo ndjenjë superioriteti e ndërsjellë lind nga vakumi që krijohet nga mungesa e dialogut. Dialogu ndërkulturor apo ndërftetar nënkupton një proces, një seri aktivitete që përsëriten për të krijuar shërbime, që në rastin tonë këto shërbime nënkuptojnë një shoqëri ballkanike më shumë të sigurt, më shumë të stabilizuar dhe më shumë të integruar. Infrastruktura e këtij procesi përfshin vetë institucionet e besimeve fetare, shoqërinë civile, intelektuale, mendian, që nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta promovojnë një mirëkuptim reciprok të diferencave që ekzistojnë midis feve dhe kulturave të ndryshme dhe duke rritur kështu edhe vetë kulturën e dialogut në shoqëri. Shoqata 'Prizmi' është një shembull konkret për rolin e saj aktiv në promovimin e vlerave të përbashkëta pozitive që kanë tre besimet kryesore fetare që funksionojnë në Shqipëri. Po kështu në Bosnjë, funksionon Këshilli Ndërfetar, i cili përfshin katër drejtuesit e besimeve kryesore fetare në këtë vend. Aktiviteti kryesor i këtij këshilli është dialogu ndërftetar si një instrument parësor për të shmangur konfliktet dhe tensionet sociale që mund t'i lindin nga paragjykimet për fetë dhe kulturat respektive.

Dialogu i vazhdueshëm dhe respektiv, për vlerat që kanë fe apo kultura të ndryshme, krijon mirëbesimin reciprok dhe

është mënyra më e mirë për të larguar paragjykimet që ekzistojnë për fe apo kultura të ndryshme. Qëllimi i përbashkët është që të mësojmë për të jetuar në harmoni me diferencat dhe kjo mund të realizohet vetëm nëpërmjet dialogut ndërftetar dhe ndërkulturor.

### Konkluzion:

Roli i kulturave dhe feve të ndryshme për forcimin e dialogut dhe bashkëpunimit midis individëve dhe kombeve në rajonin tonë merr një rëndësi edhe më të madhe në kontekstin e sotëm. Bota po ndjek terrorizmin si një kërcënim global, i cili në jo pak raste lidhet me ekstremizmin fetar.

Shkaku i terrorizmit nuk është besimi fetar, por interpretimi në mënyrë të gabuar i fesë. Kështu dialogu ndërftetar dhe ndërkulturor kërkton angazhimin e shoqërisë civile, liderëve fetarë, qeverive respektive dhe intelektualëve në një punë intensive dhe shumë të kërkuar për të ndaluar influencën në të ardhmen. Kjo do të çonte edhe në publikimin e revistave ndërftetare dhe materialeve të tjera të përbashkëta. Këto publikime do të ishin edhe reklama më e mirë e dialogut ndërftetar dhe ndërkulturor që është zhvilluar dhe është duke u zhvilluar në rajon.

Mbas një periudhe konfliktesh dhe ndarjesh në Ballkan, dialogu ndërkulturor dhe ndërftetar duket i motivuar. Çelësi i zgjidhjes së situatave delikate që mund të ekspozojë e ardhmja qëndron në promovimin e dialogut dhe bashkëpunimit rajonal. Treguesi më i mirë i maturisë së shoqërive tona është fakti se për një periudhë të shkurtër Ballkani po transformohet nga një konsumator i madhe i sigurisë, në një rajon që po ndihmon në vendosjen e paqes dhe stabilitetit kudo në botë.

Dukuritë negative në shoqërinë kosovare

# BASTORET VJEDHIN BUXHETIN E GJITHSECILIT QË LUAN NË TO

Se me të vërtet bastoret “ta shpifin” siç thonë në Shqipëri, tregon më së miri ambienti nëpër lokalet e tyre: tym duhani, servimi i alkoolit, letra të hedhura çdo kund, tavolinat dhe karriget të vendosura pa vend, zhurmë e televizorëve, etj. Një njeri normal dhe më jetë të organizuar si duhet, nuk i toleron këto gjëra.

Shkelzen DRAGAJ

**N**jë dukuri që e dëmton buxhetin e njerëzve është fenomeni i bastoreve sportive. Në shumë vende të botës ky fenomen është mjaft i përhapur, si në: Itali, Angli, Gjermani, etj. Fatkeqësisht ky fenomen kohët e fundit po praktikohet në masë të madhe edhe në Kosovë. Shumë prej atyre që merren me këtë gjë, arsyetimin e gjejnë te kushtet e rënda ekonomike, prandaj lojën nëpër bastore e shohin si rrugëdalje. Disa e përcjellin sportin shumë dhe kanë dëshirë që të prognozohet, ca tjerë duke parë se këto gjëra praktikohen në Evropë mendojnë se është moderne, dhe që të jesh në hap me kohën duhet ta praktikosh këtë gjë.

Por çfarë sjellin në të vërtet bas-

toret?

Sapo të hapësh derën e ndonjë bastoreje sheh njerëz duke prituri në rend për të vënë bastet e tyre. Shuma të cilën ata e vënë bast është e ndryshme. Ajo sillet nga 1 euro për tiket, 50 euro për tiket, madje dhe nga 500 euro, por fitimi rrallë herë vjen, për të mos thënë kurrë.

Këta njerëz shprehen se pothuajse e tërë dita u kalon në bastore. Shumica nga ata që vënë baste me para të “majme” nuk pranojnë të flasin për këtë çështje. Si duket nuk dëshirojnë ta prishin koncentrimin në ndeshjet që kanë vënë bast.

Por në mesin e lojtarëve të bastoreve ka edhe të atillë që e kanë kuptuar se kjo nuk të sjell të mira, por ata shprehen se nuk mund ta lenë.

“Për çdo javë luaj me nga një tiket, herë me 1 euro, nganjëherë 5euro”,

thotë M. R. (25) nga Skenderaj, student i Shkencave Politike.

Është fenomen që të ngre në vete, por nuk mund ta mundesh sepse në fund të barazon. Nuk lejon që ti të dalësh fitues”.

M. R. shprehet se është përpjekur që ta lë disa herë, por nuk ja ka arritur.


Po sa ja shohin “hajrin” pronarët e bastoreve këtij biznesi?

Normalisht që fitojnë. Duke parë gjithë atë shumicë njerëzish nëpër bastore kuptohet se pronarët e bastoreve marrin para të majme, por fatkeqësisht ato para nuk mund të quhen të ndershme.

Se me të vërtet bastoret “ta shpifin” siç thonë në Shqipëri, tregon më së miri ambienti nëpër lokalet e tyre: tym duhani, servimi i alkoolit, letra të hedhura çdo kund, tavolinat dhe karriget të vendosura pa vend, zhurmë e televizorëve, etj. Një njeri normal dhe më jetë të organizuar si duhet, nuk i toleron këto gjëra.

**Çka do të duhet ndërmerret për ta ndaluar këtë fenomen?**

Së pari duke parë se këto gjëra janë të dëmshme për popullin dhe se këto biznese në mënyrë indirekte “vjedhin” buxhetin familjar, shteti do të duhej t'i ndalonte. Ose do të duhej të rregullohej mënyra e reklamimit. Pasi që shpesh nëpër mediat tona shohim dhe dëgjojmë reklama për bastoret. Për të mos i nxitur njerëzit që të luajnë atëherë reklamimi do të duhej të ndalohej, që në mënyrë graduale ky fenomen të pushonte së ekzistuari.



► Interesimi ndaj orarit të lojtrave futbolistike, me i madh se sa leximi!

Histori Islame

# Muhammedi s.a.v.s. në ditët e para të Medinës

Medina me shkuarjen e Muhammedit s.a.v.s. u bë qendër e muslimanëve të udhëhequr nga personi që më vonë do të njihet nga mbarë njerëzimi, që prej asaj kohe e deri më sot... Emrat më të njohur të saj, të përmendura nga Jakuti, janë njëzet e nëntë.



Muhamed Jusufi  
- KAJOLLI

**M**uhammedi s.a.v.s. së bashku me Ebu Bekrin, mori rrugën e shpërnguljes. Kjo rrugë është skicuar nëpër shumë harta të historisë islame. Pas shumë peripecive, të cilat përshkruhen në biografinë së tij, ai para se të arrinte në qytetin e mirëpritur u stacionua për disa ditë në vendin e quajtur Kubba'. Ky vend i banuar tani është brenda qytetit të Medinës, ndërsa atëherë ishte një vendbanim shumë i vogël, fare pranë Medinës. Ky end vazhdon të frekuentohet ende për shkak se qëndrimi tij katër ditor, nga e hëna deri të enjten, kishte bërë të mundur të ngrihej një mesxhid.

Kur ishte larguar Muhammedi s.a.v.s. nga Mekka, në shtëpinë e tij qëndroi Aliu r.a. i ngarkuar me detyrë. Ai do t'i shpërndante të gjitha amanetet dhe gjësendet e huaja që ishin në shtëpinë e Pejgamberit s.a.v.s. Pas tri ditësh, Aliu r.a. arriti t'ua shpërndajë të gjithëve gjësendet dhe amanetet e tyre dhe pa hamendje mori rrugën e shpërnguljes. Një ditë para se të hynin në Medinë Aliu r.a. mbërriti në Kubba'.

Vendimin që mori i Dërguari Zotit tregon se:

- sa i kujdesshëm ka qenë Muhammedi s.a.v.s., ndaj pronës së huaj
- sa i shpejtë ishte vendimi për t'u shpërngulur. Edhe pse bënte parapërgatitjet për shpërngulje, duket se momenti i shpërnguljes ka qenë aq i papritur, sa që nuk ka pasur kohë të merret as me amanetet e huaja.

- Guximi i Aliut r.a. të qëndronte në shtëpinë e Pejgamberit s.a.v.s. dhe, të merrej me popullin e tërbuar.

Dita e parë e shpërnguljes ishte 16 korrik 622, ndërsa arritja në Medinë ishte më 24 shtator 622 ditë e premtë. Rrugës për në qytet, Muhammedit s.a.v.s. ju shpall:

që në namazin e rregullt të mesditës, ditën e xhuma (në të cilën faleshin katër rekate) të falin namazin e mbledhjes (xhumasë). Ky namaz në vete përmban Hutben (fjalimin fetaro-politik) dhe dy rekate namaz obligative. Namazin e parë të xhumasë e falën mbi njëqind vetë.

Pas namazit të xhumasë Muhammedi me të gjithë të tjerët hyri në Jethrib - Medinën e ndritur. Cili do ta kishte nderin të ishte mikpritësi i këtij njeriu që do të ndryshonte rendin shoqëror të botës? Askush. Aty ku do të ndalonte deveja e Muhammedit s.a.v.s., aty do të vendosej shtëpia e tij. "Deveja Kasua ra në gjunjë para një dyqani që i përkiste dy vëllezërve jetimë dhe nuk dëgjoi të lëvizte nga vendi. Muhamedi zbriti, pranoi që t'ia çonin gjërat që kishte me vete te shtëpia më e afërt dhe filloi të bisedonte me dy vëllezërit për blerjen e tokës së tyre. Sapo ata ranë dakord për një çmim të arsyeshëm, ai dha urdhër që të filloheshin punimet për një xhami, e cila do të ishte edhe shtëpia e tij. Të gjithë shkuan të punonin, emigrantët (muhaxhirët) punonin përkrah ensarëve"

## Medina

Më herët theksuam se emri Medine ose Jethrib kishte kuptimin 'qytet', si ndër arabët ashtu edhe ndër çifutët. Ky vend ka edhe shumë emra të tjerë. Mbase këto emërime janë rezultat i mikpritjes që vendasit i bënë Muhammedit s.a.v.s. Zakonisht nëse dikush e do një njeri ose një vend, nuk ngopet duke i thurur vargje ose duke i vënë epitetet të shumta e të ndryshme. Kënaqësia tek njeriu do të arrihet vetëm atëherë kur ai nga dashuria e thërrret me emra të rij, të cilat atij i kujtohen për ato momente. Si duket Medina është një vend i tillë. Kur kam shkruar për herë të parë në këtë qytet, them se ishte një qytet që të krijonte ndjenjën e qetësisë. Emrat më të njohur të saj, të përmendura nga Jakuti, janë njëzet e nëntë.

Medina me shkuarjen e Muhammedit s.a.v.s. u bë qendër e muslimanëve të udhëhequr nga personi që më vonë do të njihet nga mbarë njerëzimi, që prej asaj kohe e deri më sot. Meqenëse u bë qendër dhe u bë një përmbysje e madhe shoqërore, dita e parë e shpërnguljes së Muhammedit s.a.v.s. u bë edhe viti i parë

kalendrik i muslimanëve. Më herët, arabët vitet i përkujtonin me ngjarjen e madhe të poshtërimit të ushtrisë së elefantëve të udhëhequr nga Ebreheja, që ata e quanin Viti i Elefantëve.

Strukturat e shoqërisë së Medinës me shkuarjen e Muhammedit s.a.v.s. ishin ato të vendasve të fisit:

1. Hazrexh, dhe Evs, prej tyre kishte muslimanë dhe jo muslimanë
2. Tri fiset çifute, shumica dërmuese e të cilëve nuk e pranoi Islam
3. Muhaxhirët e Mekkës, të gjithë musliman

## Iniciativat e Muhammedit s.a.v.s.

Që kur Muhammedi e ngriti xhaminë e parë, ajo shërbeu si faltore, shkollë, akademi, takim mbledhjesh, konferencash etj. Iniciativa e parë ishte vëllazërimi i muslimanëve vendas me muhaxhirët. Ndërsa iniciativa e dytë ishte bashkimi i të gjithë qytetarëve të Medinës. Marrëveshja e këtij bashkimi është e ruajtur dhe me të drejtë muslimanët konstatojnë se është kushtetuta e parë e zbatuar në botë dhe ajo është quajtur:

## Karta e Medinës

Në emër të All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Kjo marrëveshje e Pejgamberit të All-llahut, Muhammedit s.a.v.s. u drejtohet të migruarve, Kurejshëve, qytetarëve të Jethribit (Medinës) që e kanë pranuar Islam dhe të gjithë atyre njerëzve që janë në marrëveshje me grupet e përmendura më lart dhe marrin anën e tyre në kohë lufte.
2. Të gjithë ata që bëjnë pjesë në këtë marrëveshje do të trajtohen si grup i ndarë prej të gjithë atyre që nuk janë pjesë e kësaj marrëveshjeje.
3. Kurejshët e migruar, si edhe më parë, përbëjnë një grup më vete, ata duhet të jenë përgjegjës për shpagimin e gjakut të kriminelëve të tyre dhe ata vetë duhet t'i lirojnë robërit e tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të jetë në përputhje me parimet e besimit (Imanit) dhe drejtësisë.
4. Benu Auf duhet të jenë përgjegjës për vetë fisin e tyre dhe duhet bashkërisht ta paguajnë shpagimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe duhet të jenë vetë përgjegjës për lirin e robërve të tyre

pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.

5. Benu El-Haris duhet të jetë përgjegjës për vetë fisin e tyre dhe duhet bashkërisht ta paguajnë shpërgjimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.

6. Benu Sa'ida duhet të jenë përgjegjës për vetë fisin e tyre dhe duhet bashkërisht ta paguajnë shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.

7. Benu Xhusham duhet të jenë përgjegjës për vetë fisin e tyre dhe duhet bashkërisht ta paguajnë shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.

8. Benu En-Nexhhar duhet të jenë përgjegjës për vetë fisin e tyre dhe duhet bashkërisht ta paguajnë shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.

9. Benu Amr duhet të jenë përgjegjës për vetë fisin e tyre dhe duhet bashkërisht ta paguajnë shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe

drejtësisë.

10. Benu El-Wabijjat duhet të jenë përgjegjës për vetë fisin e tyre dhe duhet bashkërisht ta paguajnë shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.

11. Benu El-Ews duhet të jenë përgjegjës për vetë fisin e tyre dhe duhet bashkërisht ta paguajnë shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.

12. Nëse në radhët e muslimanëve një njeri i varfër është fajtor i ndonjë sulmi, për të cilin shpagimi i gjakut bëhet i detyrueshëm ose ai merret rob dhe nuk është i aftë vetë ta paguajë shpërblimin për lirim; duhet të jetë detyrë e muslimanëve të tjerë ta paguajnë në emër të tij shpërgjimin e gjakut ose shpërblimin për lirim dhe ta lirojnë atë, me qëllim që, në marrëdhëniet e ndërsjella të muslimanëve, të krijohen virtytet dhe dashamirësi.

13. Asnjë musliman nuk duhet të armiqësohet me një rob të liruar prej një muslimani tjetër.

14. Është detyrë e muslimanëve të kundërshtojnë hapur çdo person që shkakton dëme dhe trazira, shqetëson njerëzit ose do t'iu grabisë diçka me forcë dhe përdor dhunën. Të gjithë muslimanët duhet të mbeten të bashkuar njëri me tjetrin, në dënimin e një personi të tillë, madje edhe nëse ai është djali i ndonjërit prej tyre.

15. Muslimani nuk ka të drejtë të vrasë një musliman tjetër në shkëmbim të një të pafeje (i cili është në gjendje lufte) ose të ndihmojë një person, i cili është në

gjendje lufte me muslimanët.

16. Premtimi i All-llahut, përgjegjësia dhe përkrahja janë të njëjta për të gjithë. Kjo do të thotë se nëse një musliman i jep strehim ndonjërit, duhet të jetë detyrë e të gjithë muslimanëve ta nderojnë atë, edhe nëse muslimani që e ka siguruar të strehuarin mund të jetë prej shtrese të ulët. Të gjithë muslimanët janë të vëlazëruar ndërmjet vete, në krahasim me të tjerët.

17. Është detyrë e të gjithë muslimanëve të ndihmojnë dhe t'u ofrojnë sjellje miqësore çifutëve, të cilët kanë hyrë në marrëveshje me ta. Asnjë shtetëngim i çfarëdo lloji qoftë nuk duhet ushtruar mbi ta dhe nuk duhen ndihmuar armiqët e tyre kundër tyre.

18. Armëpushimi i të gjithë muslimanëve duhet të jetë i njëkohshëm: Kur ka luftë në rrugë të All-llahut, asnjë prej muslimanëve s'duhet të mënjanohet prej muslimanëve të tjerë, apo të hyjë në traktat paqe me armikun, veçse nëse traktati është i njëkohshëm dhe i njëjtë për të gjithë muslimanët.

19. Të gjitha grupeve, të cilat marrin pjesë në luftë bashkë me ne, do t'u jepet mundësia për të pushuar me radhë.

20. Nëse një musliman bie dëshmor në rrugë të All-llahut, furnizimi i jetës së atyre që varen prej tij duhet të jetë përgjegjësi e të gjithë muslimanëve.

21. Pa asnjë dyshim të gjithë muslimanët e devotshëm që i frikësohen Zotit janë në rrugë të drejtë dhe janë pasues së rrugës më të mirë të jetës.

22. Asnjë jomusliman që është palë e kësaj marrëveshjeje, nuk duhet të sigurojë strehim të jetës dhe të pronës së ndonjë Kurejshi e as duhet të ndihmojë ndonjë jomusliman kundër një muslimani.

23. Nëse dikush vret një musliman dhe për këtë ka fakte kundër tij, vrasësi duhet të ndëshkohet. Por nëse farefisi i afërm është pajtuar të pranohë shpërgjimin e gjakut, vrasësi duhet të lihet i lirë. Duhet të jetë obligim i të gjithë muslimanëve ta respektojnë këtë vendim pa asnjë përjashtim. Asgjë tjetër përveç asaj që paracaktajnë urdhrat nuk duhet të pranohet.

24. Për një musliman i cili pas pranimit të marrëveshjes, ka rënë dakord që ta respektojë atë, dhe ai beson në All-llah dhe në Ditën e Gjykimit, atij nuk i lejohet të sajtojë asnjë veprim apo zakon të ri, e as do të ishte e pranueshme që ai të ketë marrëdhënie tregtare me një person që nuk e respekton këtë marrëveshje. Mallkimi dhe zemërimi i Zotit do të bie në ditën e Gjykimit mbi cilindo që shkel këtë marrëveshje dhe në këtë drejtim asnjë shfaqësim dhe asnjë kërkesë për falje nuk do të pranohet prej tij.

25. Kur të lindin mosmarrëveshje të dyanshme rreth ndonjë pike të kësaj marrëveshjeje, çështja do të drejtohet për vendim All-llahut dhe Muhammedit s.a.v.s.

26. Pas traktatit, çifutët do të jenë të obliguar t'iu dorëzojnë muslimanëve ndihmë financiare, kur ata janë në luftë



► Xhamia e Muhammedit s.a.v.s. nga brenda!

me armikun.

27. Çifutët e fisit Benu Auf, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të muslimanëve, duhet të përmbahen me vendosmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyres. Përveç çështjeve fetare, muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej tyre kryen shkelje brutale, ose thyen betimin, ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

28. Çifutët e Benu En-Nexhhar, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të muslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyres. Përveç çështjeve fetare, muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej tyre kryen shkelje brutale, ose thyen betimin, ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

29. Çifutët e fisit Benu El-Haris, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të muslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyres. Përveç çështjeve fetare muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale ose thyen betimin, ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

30. Çifutët e fisit Benu Sa'id, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të muslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyres. Përveç çështjeve fetare muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale ose thyen betimin, ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

31. Çifutët e fisit Benu Hashim, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të muslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyres. Përveç çështjeve fetare muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale ose thyen betimin, ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

32. Çifutët e fisit Benu El-Avs, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të muslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyres. Përveç çështjeve fetare muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale ose thyen betimin, ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

33. Çifutët e fisit Benu Sa'laba, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të muslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyres. Përveç çështjeve fetare muslimanët dhe çifutët

duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale ose thyen betimin, ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

34. Çifutët e fisit Benu Xhafna, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të muslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyres. Përveç çështjeve fetare muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale ose thyen betimin, ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

35. Çifutët e fisit Benu El-Shataiba, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të muslimanëve, duhet të përmbahen me vendosmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyres. Përveç çështjeve fetare muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale ose thyen betimin, ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

36. Degët e varura prej fiseve të përmen-dura më lart do të kenë të drejta të njëjta me ato që gëzojnë degët bazë.

37. Asnjë prej hartuesve të traktatit nuk mund të marrë ndonjë aksion ushtarak pa lejen e Muhammedit s.a.v.s.

38. Asnjë pengesë nuk duhet të shkaktohet në kompensimin apo shpagimin e ndonjë plage apo goditje. Kushdo që bën shkeljen e betimit meriton të ndëshkohet për këtë dhe cilido që i përmbahet me shumë vendosmëri këtij traktati, All-lahu do ta ndihmojë atë.

39. Nëse një bashkësi e tretë zhvillon luftë kundër muslimanëve dhe çifutëve, pjesëmarrës në traktat, ata do të duhet të luftojnë bashkërisht. Ata duhet ta ndihmojnë njëri-tjetrin reciprokisht dhe ndërmjet tyre duhet të ekzistojë dashamirësia dhe besueshmëria e ndërsjellë. Çifutët duhet t'i përballojnë shpenzimet e tyre të luftës dhe muslimanët shpenzimet e tyre.

40. Është detyrë e palëve të kësaj marrëveshjeje të sillen me njëri-tjetrin sinqerisht dhe t'ia dëshirojnë të mirën njëri-tjetrit. Asnjëri nuk duhet ta bëjë tjetrin objekt shtypjeje dhe padrejtësie dhe i shtypuri duhet të ndihmohet.

41. Çifutët duhet t'i ndajnë shpenzimet së bashku me muslimanët për aq kohë sa ata luftojnë bashkërisht.

42. Rafshina e Jethribit, e cila rrethohet prej kodrave do të jetë haram (stre-

him) për palët pjesëmarrëse të traktatit. 43. I njëjti trajtim duhet të bëhet edhe ndaj një refugjati, që konsiderohet personi të cilit i është dhënë e drejta e strehimit, ai nuk duhet të dëmtohet. I strehuari duhet ta respektojë këtë marrëveshje dhe ai nuk duhet të lejohet ta thyejë premtimin.

44. Askush nuk duhet të strehojë një refugjat pa lejen e njerëzve të këtij vendi.

45. Nëse ka ndonjë moskuptim apo mosmarrëveshje të mendimeve midis palëve pjesëmarrëse të traktatit, e cila mund të çojë në prishjen e paqes, çështja duhet t'i drejtohet për zgjidhje All-llahut dhe Muhammedit, të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. All-llahu do të jetë me atë, i cili më së shumti i përmbahet traktatit.

46. Askush nuk duhet të garantojë mbrojtje për Kurejshët e Mekës apo për ndonjë nga përkrahësit e tyre.

47. Nëse Jethribi (Medina) do të pushtohet, muslimanët dhe çifutët bashkërisht duhet t'iu kundërvihen me një mbrojtje të bashkuar.

48. Nëse muslimanët bëjnë traktat paqeje me ndokënd, çifutët duhet ta respektojnë atë. Edhe nëse çifutët bëjnë paqe me ndokënd, muslimanët janë të obliguar të ofrojnë bashkëpunim të ngjashëm me çifutët. Por në rast të një lufte fetare të njëres palë, nuk do të jetë përgjegjësi e palës tjetër të bashkëveprojë në të.

49. Në rast të pushtimit të Medinës, secila palë duhet të mbrojë pjesën që është përpara saj.

50. Përkrahësit e fisit Evs do të kenë të drejta të njëjta ashtu sikurse gëzojnë edhe palët pjesëmarrëse të këtij traktati me kusht që ata të dëshmojnë besnikërinë e tyre. All-llahu është Mbrojtësi dhe Përkrahësi i atij, që i përmbahet me vendosmëri më së shumti këtij traktati.

51. Nëse ndonjëri prej palëve pjesëmarrëse të këtij traktati, duhet të dalë jashtë Medinës për shkak të kërkesave urgjente të luftës, ai duhet të gëzojë të drejtën e mbrojtjes dhe përkrahjes. Gjithashtu edhe cilido që qëndron në Medine gëzon të drejtën e paprekshmërisë. As nuk duhet të dhunohet ndokush, e as nuk duhet të lejohet që ai ta shkeli premtimin. All-llahu dhe i Dërguari i Tij s.a.v.s. do të jenë mbrojtësit e cilitdo, që do ta respektojë me gjithë zemër këtë marrëveshje dhe do t'i bindet asaj.



**Pamja e jashtme e xhamisë në Medinë.**

## Leximi i tekstit

# MODELET POETIKE NË PËRMBLEDHJEN “PLAGOMË” TË SALI BASHOTËS

Libri poetik “Plagomë”, është pjesë e vlerave të letërsisë së sotme shqipe dhe ne theksojmë se teksti / poezia “Miti rreth kërcimit në varr”, është tekst antologjik, nëse kihet parasysh raporti i tij me kohën e shkrimit dhe poetikën e shkrimit asociativ në letërsinë shqipe.

## Adil OLLURI

Përmes këtij shkrimi eseistik do të mundohemi t'i interpretojmë poezitë e Sali Bashotës të përmbledhura në librin poetik “Plagomë” të botuar për herë të parë në vitin 1994 dhe të ribotuar së dyti nga SH.B. Rozafa, në vitin 2004. Por, para se të hyjmë në interpretimet direkte të poezive të tij do të bëjmë një shpjegim zbrërthyes të titullit metaforik të këtij libri “Plagomë”, titull me të cilin shënjohej edhe një poezi brenda librit, poezi e cila i kushtohet Mitrush Kutelit për tekstet e tij: ‘Poemi Kosovar’ dhe ‘Poemi i Shëndaumit’. Nëse e lexojmë këtë poezi në relacion me librin në tërësi dhe dy tekstet e sipërpërmendura të Kutelit, atëherë do të shohim se tekstet e Bashotës me ato të Kutelit kanë një ndërlidhje apo relacion ideor tematizues, siç është shenja e tematizimit të tragjizmit nacional, fatalitetit, agresivitetit dhe ideja e mbijetimit të këtij tragjizmi. Por, këtu duhet të jemi të qartë, se, tekstet e

Bashotës ndërlidhen me ato të Kutelit vetëm në nivelin e tyre ideor e tematizues, e assesi në nivelin e formës, sepse forma e teksteve të Bashotës për dallim prej teksteve poetike të Kutelit është kryesisht tjetër fare.

**I. Forma e shenjës**

Në leximin e formave të shenjave poetike duhet që së pari t'i shpalojmë zhanret dhe statuset e këtyre teksteve poetike, ku ne, gjatë leximit, vëmë re se shumica e poezive të Bashotës i takojnë zhanrit të lirikës meditative, si formë mbizotëruese në këto tekste poetike. Por, përveç lirikës, ky libër përmban edhe një sërë zhanresh të tjera, si proza poetike që si zhanër përfaqësohet me këto tekste “Liri me gjarpër në gji”, “Forma artistike e lirisë”, si tekstet më reprezentative për këtë zhanër. Përpos këtij zhanri, kemi edhe lirikën nacionale që në esencialisht përfaqësohet me “Lirikë për Dimalin”, dhe përveç kësaj kemi vetëm një lirikë erotike “Martirja e dashurisë”. Megjithatë, ne, duhet ta pranojmë se diskursi në poezitë e Bashotës është esencialisht meditativ, dhe ky dal-

lim zhanror nuk është në plan të parë, sepse në fakt kemi një përzierje zhanrore, siç është rasti me poezitë “Atdheu”, “Robëria” ku kemi një gërshetim zhanror ndërmjet lirikës nacionale dhe meditative, apo edhe vetë poezia “Plagomë” që ka një përzierje zhanrore ndërmjet lirikës përkushtuese e meditative. Kjo eklikë/përzierje e llojeve e zhanreve letrare është shenjë e teknikës së shkrimit postmodern, gjë që vërehet në poezitë e Bashotës. Sipas kësaj, është vetë diskursi meditativ ai që funksionon si element që i ndërlidh sistematikisht këto tekste. Në këto tekste ekzistojnë një sërë shenjash poetike, të cilat i sintagmatizojnë dhe figurojnë shumicën e teksteve, siç janë, shenjat poetike Gjarpri, Liria, Gjiri, Durimi, Ankthi, të cilat gjatë riciklimit të vazhdueshëm ideor e tematizues marrin funksione e konotime përtej sintagmatike, duke u ngritur kështu në shkallën simbolike të shenjës poetike. Këtë status/shkallë e arrin sidomos sintagma Gjarpër e cila gjatë riciklimit të vazhdueshëm procesual, bëhet një paradigmë e rëndësishme simbolizuese për tërë tekstin/librin e Bashotës.

Në këto tekste i kemi perceptuar dy modele apo teknika të shkrimit, siç është modeli asociativ i shkrimit, i cili më esencialisht përfaqësohet me poezinë “Miti rreth kërcimit në varr”, dhe modelin ekspresiv të shkrimit, i cili më denjësisht përfaqësohet/reprezentohet me poezinë “Ditëzeza”, e cila realizon një formë joasociative të shkrimit. Modeli i parë asociativ për dallim prej të dytit është më subjektiv, ku shenjat poetike asociojnë paradigmë/kuptimësinë e tekstit, për dallim prej modelit ekspresiv, i cili edhe pse ka në vete sugjektivitetin, prapë se prapë shenja është më e hapur për komunikim /dialogim. Duhet theksuar këtu se në sistemin figurativ të këtyre teksteve përveç metaforës, si figurë kryesore, vend të rëndësishëm zë edhe paradoksi, që si figurë është e shprehur veçanërisht te tekstet që realizojnë modelin asociativ të shkrimit. Ja një shenjim i kësaj figure:

*“ka shekuj që murgësja e shenjtë më blen*



► Poeti, Sali Bashota

*helm në një dyqan të vjetër*

Në këto tekste kemi të shënjuara mjaft neologjizma poetike, t'i përmendim disa "dhembshkrimi, shqipshkrimdhembjekrijimi, vdekjeliria. Këto neologjizma i japin ngjyrë kreative edhe në aspektin gjuhësor librit.

**II. Komunikimi me tekste**

Komunikimin/interpretimin e këtyre shenjave poetike/teksteve poetike duhet ta realizojmë duke i parë këto tekste në relacion me kohën e shkrimit në të cilën janë shkruar e botuar për herë të parë, pra duhet t'i shohim tekstet si shenja të kontekstit, si produksion mimetik të viteve të '90-ta.

Nisur në këtë logjikë, do ta interpretojmë sintagmën "Liri me gjarpër në gj", me të cilën emërtohen tri pjesët e librit:

1. LIRI- Libri i lindjes
2. ME GJARPËR- Libri i jetës
3. NË GJI- Libri i vdekjes

Përmes kësaj paradigme skematizuese shënjohe subjekti ligjërues, që në këtë kontekst identifikohet me njeriun e Kosovës të viteve të '90-ta, i cili këtu paraqitet në tri nivele të qeniesimit/ekzistimit të tij. Në nivelin e parë ai lind si genie që gjakon/kërkon lirinë si kusht i domosdoshëm ekzistence. Në nivelin e dytë të qeniesimit paraqitet jeta e tij në ankt dhe ballafaqimi i tij me gjarpurin, rezikun e përhershëm të kafshimit/dëmtimit të tij nga gjarpri. Gjarpri këtu simbolizon të huajin, armikun e njeriut shqiptar të Kosovës, më konkretisht nëse bëjmë interpretim alegorik gjarpri si figurë identifikohet me robëruesin serb. Ndërsa, në nivelin e tretë shënjohe vdekja e tij metafizike, asgjësimi i tij kur gjarpri i futet në gj, në brendësi të tij.

Tash do të fillojmë t'i interpretojmë disa poezi që mendojmë se esencialisht janë më reprezentative në relacionin formal e tematik në kuadër të librit poetik "Plagomë". Teksti "Lirikë për Dimalin", që është lirikë nacionale, shënjon paradigmen e arkikujtesës nacionale, kujtesës ilire. Dimali është një vend ilir që pak a shumë është i mënjanuar nga kujtesa jonë e tanishme, ku në këtë rast ligjërimi i tekstit shpreh njëkohësisht edhe dhimbje edhe krenari. Dhimbje për humbje të vendit real/toposit etnogjenetik, por njëkohësisht shpresohet edhe shënjohe krenaria për trashëgiminë ilire.

Leximi i prozës poetike "Liri me gjarpër në gj" na bën të mendojmë se Bashota e zotëron mirë teknikën e shkrimit asociativ edhe në krijimin e formës prozaike. Në këtë tekst është e pranishme figura e paradoksit. Si temë në këtë tekst shënjohe anktin i subjektit ligjërues për mundësinë e humbjes së mëtutjeshme etnike.

Teksti "Atdhesi", ka status të lirikës së

meditimit nacional. Në këtë tekst paradigmatozohet ideja e veprimt, luftës për liri personale e atdhetare.

*"A thua vetëm gjaku skuq mallin atdhetar"*

Teksti që ka status të lirikës meditative "Si në shtratin e Prokrustit" ka një ndërfutje paradigmatozike të mitit të Prokrustit. Duke e lexuar këtë tekst ne e vërejmë se këtu kemi një postmodernizim të mitit, ku miti riciklohet dhe i merret esenca, e cila është në gjendje të dialogojë me kohën reale të shkrimit, duke e bërë kështu mitin tematikisht të aplikueshëm për kohën. Kjo teknikë postmoderne e montimit të shenjës mitike e fut Bashotën në mesin e poetëve postmodernë.

*"Prokrusti i mbledh të gjallët në log"*

Ky tekst esencializon temën e papërshtatshmërisë jo vetëm të individit, por të tërë njerëzve/shoqërisë ndaj një sistemi/regjimi Prokrustian, i cili është në gjendje ta dëmtojë cilindo që është i papërshtatshëm.

Teksti "Miti rreth kërcimit në varr" është poezi asociative, e cila realizohet përmes një logjike dhe teknike të shkrimit asociativ. Tekstin e zotëron figura e paradoksit.

*"Gruaja thith gjinjët e vet të bekuar."*

*Të gjashtë fëmijët kërcëjnë rreth zjarrit*

*Me ujkonjën e tërbuar në duar*

*i shtati i bie dauilleve të tmerrit a varrit"*

Tematizohet paradigma e dhunës, agresivitetit njerëzor, agresiviteti i cili zhvillohet deri në shkallën e tij fatale, një agresiviteti cili i tejkalon përmasat e tij njerëzore dhe arrin shkallën e tij mi-

tike. Pra, agresiviteti bëhet mit i kohës, mit i viteve të '90-ta. Duhet të shtojmë këtu se ky tekst ka status polisemik.

Teksti "Martirja e dashurisë", është një lirikë erotike me një tematikë tragjike, sepse në strukturat e saj shënjohe e dashura, e fejuara dhe loti i saj përmbi varrin e të dashurit të saj martir. Ky tekst është i realizuar në strukturën e sonetit dhe i përket modelit apo teknikës së shkrimit ekspresiv.

Teksti "Gjumi në shtratin e dashurisë", ka një temë të veçantë, temën e dashurisë së individit nën kohën e stresit, kafshimit të gjarpurit, robërisë. Ky tekst vë në spikamë paradoksalitetin e kohës, ku dhe dashuria/seksi që është personal bëhet nën ankthin e dhunës, robërisë që është diçka e përgjithshme, kolektive. Pra, këtu si premisë realizohet njësimi i personales me të përgjithshmen. Lirikë meditative "Meditim i trishtë" është tekst me rëndësi për faktin se titulli i këtij teksti e tregon pozicionin / statusin e ligjërimin në këto tekste të Bashotës, si meditim i trishtuar, ligjërim me anktin subjektiv. Statusi i librit përcaktohet edhe në peritëksin inicial të librit "Libër lirik i rimuar në riga gjaku". Siç shihet qysh në fillim përcaktohet paradigma e tragjizmit të kohës, tragjizmit objektiv. Dhe për fund duhet të theksojmë se libri poetik "Plagomë", është pjesë e vlerave të letërsisë së sotme shqipe dhe ne theksojmë se teksti /poezia "Miti rreth kërcimit në varr", është tekst antologjik, nëse kihet parasysh raporti i tij me kohën e shkrimit dhe poetikën e shkrimit asociativ në letërsinë shqipe.



Trishtimi dhe ftohtësia e subjektit!

## Leximi i tekstit

**POEZIA E RIKTHIMIT NË KUJTIME**

Kujtimet e shënjuara, së bashku me mallin, sintetizojnë idetë që tani identifikohen plotësisht përmes fikSIONIT të shkrimit. Malli përbën indin ideor gjatë rikthimit në kujtime. Kjo, njëkohësisht sjell emocionalitetin nga një gjendje përjetuese.

**Flamur MALOKU**

**M**arrë në përgjithësi poezitë e Astrit Veliqit të vepra MOZAIK NË KUJTIME, botuar kohët e fundit nga shtëpia botuese 'Logos-A' në Shkup, shënjojnë rikthimin e të shkuarës, që tani gjatë tekstit shqiptohen si kujtime. Kështu rikthimi dhe kërkimi i së shkuarës prodhon në strukturën e poezive mallin subjektiv. Kujtimet e shënjuara, së bashku me mallin, sintetizojnë idetë që tani identifikohen plotësisht përmes fikSIONIT të shkrimit. Malli përbën indin ideor gjatë rikthimit në kujtime. Kjo, njëkohësisht sjell emocionalitetin nga një gjendje përjetuese. Emocionaliteti rri në gjenezë të shprehjes e të figurës (strukturës së figurshme K. M. Shala). Figura shoqërohet përmes emocionit që bëhet pjesë e identifikimit autorial, si shtresë metaforash në kumtim

të rikthimit në kujtim. Pra, figurshmëria lidh kujtimet përmes figurës: subjekti mposht harrimin. Prandaj, çdo figurë bëhet zbulim i kujtimit, njëkohësisht edhe përjetim i momenteve gjakuase personale. Një gjë të tillë autori e shpreh në poezinë 'Dikur'

*Më deshe  
Nën çadër  
Buzë lumit  
Prapa grilash  
Dikur, ah, kur*

Në këtë rast kujtimi del si shenjë e botës së brendshme të shënjesit. Në të njëjtën kohë del edhe si dëshmi shpirtërore. Teksti këtu bashkon mallin me shqetësimin subjektiv përmes artikullimit të dëshpëruar. Kjo elaborohet më së miri në poezinë 'Shi'

*Stuhi  
Pika shiu  
Në dritare  
Embrion  
Një kujtim*

Kjo tregon se si subjekti lirik thur të tashmen përball kujtimit. Aty figura e shiut jep trishtimin e brendshëm. Pra, figura e shiut e shtyn tekstin nga malli nëpërmjet gjakimit që të thurë kujtimet. Shtresimi i mallit dhe kërkimi i kujtimeve koncepto-

het edhe në poezinë 'Sonte', në të cilën kujtimet lidhen më dikë. Edhe këtu shiu luan rolin kyç si figurë e si ide :

*Sytë mbjellin gjumin  
Në këtë çast  
Me shi...  
Një molisje ndizet  
Mbi shtrat  
N'vetmi...*

Subjekti ka hyrë në vetmi, në mbretërinë e kujtimeve duke kërkuar e artikuluar mallin. Ligjërimi i figurshëm është kryqëzuar me situatat e dikurshme, kësi lloji auto-referencialiteti është lehtë i identifikueshëm. Prandaj edhe poezia 'Sonte' si tekst është hapje ndaj kujtimit në kërkim të së dikurshmes. Autori e sheh vetën të molisur përballë kujtimeve. Mirëpo kujtimet e tilla janë mundësi edhe për statusin e definimit kategorial të tekstit. Këtu ka kërkim dhe reflektim të kërkimit. Prandaj mbizotëron figurshmëria dhe ndjeshmëria autoriale gjatë perceptimit të kujtimit. Dhembja e kërkimit dhe e zbulimit vjen si hapje e botës së brendshme personale, e cila shumëfishohet si një gjakim jo vetëm në tekst, por edhe në jetë. Prandaj, Astrit Veliqi shtreson kujtimet e gjakuara të cilat bëhen esenciale në strukturimin ideor.



► **Shiu i kujtimit!**

Vitrina e librit

# Libra të rinj

Berat DAKAJ

**V**epura më e re poetike e Kasëm Trebeshinës “Këngë për Kosovën” përmbledh në vete tri zhanre shkrimesh: poezi, poema dhe baladë (kjo e fundit rrinë në një shtrat tjetër, jo në tipin e baladës, meqenëse merr një përcaktim të tillë). Te poezitë, pjesa e parë - statusi i tyre diskursiv sillet rreth atij deskriptiv, meditativ, përkushtues, erotik. Qendër kryesore e poezive të Trebeshinës është Kosova, njeriu i Kosovës, historia e saj së bashku me Luftën e Ushtisë Çlirimtare të Kosovës. Poezitë e tij bartin dhe rindërtojnë një poezi historike, që shpalosin kujtime për figura të mëdha atdhetare, njerëz të cilët në një anë shpalosin karakterin e tyre dhe, në anën tjetër, që bëhen objekte të poezive.

Nuk mungojnë as poezitë që sillen mes stilit të satirës dhe ironisë. Pjesa e dytë e veprës “Poema”, së cilës si program hapjeje i rrinë epigrami “Dushaniada”, dhe përcaktuesi i zhanrit “Poemë burleske” në të dëshmohet edhe më shumë stili ironik që kalon edhe në kufijtë e parodisë. Kërkohej çështja e identitetit. Përkaj temës kalojnë dushmanët, krajl, engjëjt, djajtë, dhe në bashkërendim dhe dialogim njëra figurë me tjetrën arrin deri te një zhveshje e madhe satirike, që mohon lidhjen e bisedës mes figurës së engjëllit dhe drejt. Poemat tjera (në këtë vepër) “Balada kosovare – Luftëtarëve të UÇK-së” dhe “Të Shtatë Lisat dhe Dafina – Të rënëve për çlirimin e Kosovës” kanë një stil tjetër. Zhanri i shkrimit është po ai. Temë është lufta e UÇK-së, figura janë ushtarët, dëshmorët. Kurse te poema e fundit “Kosova, stinë shtegtimesh”, këndohet një dhembje më e madhe, më e prekshme, ajo e Kosovës e pasluftës, statusi i saj i pazgjidhur. Librin e ka botuar “Buzuku”, Prishtinë, 2007, fq. 150. “Paradigma kadareane” është teksti kritik i Basri Çapriqit që ka si temë kryesore interpretimin e simboleve në veprën e Kadaresë. Objektet reale në veprën e Kadaresë si muret, piramidat, kali i drunjte, kështjellat etj., janë vetëm disa nga simbolet nëpër të cilat kalon Çapriqi në rrugën kërkimore të studimit të vet. Interesimi për anën simbolike të këtyre simboleve ndërlihd edhe figurat tjera të veprës së Kadaresë, pikërisht kuptimet simbolike të kohës me shi, me diell etj. Në këtë tekst, rrjetë simbolike dhe interpretuese, kalojnë romanet, “Gjener-




ali i ushtisë së vdekur”, “Shkaba dykrenore”, “Qorrfermani”, “Pashallaqët e mëdha”, Kush e solli Doruntinën”, “Piramida”, “Ura me tri harqe”. Çapriqi, si duket, ka hetuar edhe raportin e njërit roman me tjetrin, motivin

dhe lajtmotivin e tyre. Në kërkim të vazhdueshëm për qasje sa më të qartë ndaj simbolit, autori vë komunikim edhe me libra tjerë teorikë, te të cilët krijon një referencë që nuk gjendet afër librave të Kadaresë, por që janë interpretime të ndryshme për librat tjerë e që i ndihmojnë në çështjen e studimit të tij. Librin e ka botuar “Onufri”, Tiranë, 2006, fq. 80.

“Diskurset e ideve në prozën e Kadaresë” është libri i parë i kritikut Gëzim Aliu. Teksti i tij është i ndarë në dy pjesë, të cilave iu paraprijnë edhe dy parakapituj që lidhen me nocionin e diskursit, me domethënien e këtij nocioni si dhe me diskursin e ideve në prozën e Kadaresë. Diskursi në këtë libër nënkupton rrafshin e retorikës, stilistikës dhe narratives. Vrapimi i autorit nëpër këtë rrjetë komunikimi e përforcon qëndrimin e formësimit të ideve “letrare”. Nocioni diskurs, sipas Aliut, merr kuptimin e intencës autoriale, ku shkrimi artistik bën të mundshëm edhe ndërtimin e ideve, qofshin ato “letrare”, ideologjike, socio-politike etj.

Pjesa e parë “Diskurset e prozës artistike” shfaqet si kërkim pelegrin i interpretuesit drejt diskursit të ideve nëpër prozën e Kadaresë, më saktësisht duke marrë si modele romanët: “Gjenerali i ushtisë së vdekur”, “Kronikë në gurë” dhe “Pallati i ëndrrave”. Në “Diskursi eseistik” (pjesa e dytë e tekstit), të tëra diskurset integrohen dhe bashkëven-



dosen në veprën “Ftesë në studio” dhe në “Eskilky humbës i madh”, ku, në këto, “flet Kadareja”. Aliu ka një qasje strukturaliste ndaj diskurseve dhe ideve letrare, e aq më tepër një guximshmëri për konstatim të kësaj proze si ideoproze.

Librin e ka botuar “Faik Konica”, Prishtinë, 2007, fq. 177.

“Kur buza puthjen e gënjente...”, është vepra me 100 poezi të përzgjedhura nga gjuha angleze, është vargu më poetik i poezisë “Kur ne të dy u ndamë” i George Lord Byron, përkthyes i të cilave në gjuhën shqipe është Rudi Bobrati. Poezitë janë të përzgjedhura nga 68 poetë, dhe poezia e fundit figuron me emrin “Anonimus”, që nënkupton autorësinë e popullit. Në këtë tekst janë përzgjedhur poezitë e autorëve, si: Uiliam Shekspir, Aleksandër Pope, Uiliam Blake, Uiliam Uordsvorth, Xheorxh Lord Bayron, John Klare, Edgar Allan Poe, Rudyard Kipling, Emily Dickinson, T. S. Elioti, Ezra Pound etj. Poezitë e këtij libri si zhanër të pastër kanë lirikën. Si kodë tematikë dashurinë, meditacionin. Si subjekte të poezisë kanë veten Unë-Ti, vetë e lirikës, objektit, përkushtimit. Shumë nga këta poetë, poezitë e të cilëve janë përzgjedhur edhe me nga tri e katër, ose edhe më një poezi të vetme, në letërsi njihen edhe si përfaqësues të rrymave të ndryshme letrare. Libri shoqërohet me një CD, në të cilën recitohen mbi 15 poezi nga ky libër, nga aktorët Tina Kurti, Timo Flloko, Yllka Mujo, Ndrizim Xhepa. Librin e ka botuar “alpPA-PER”, Tiranë, 2006, fq. 280.



## Skicë tragjedia

## SUVENIR

## Valmira PEÇI

## PROLOGU

Po i lutem Zotit që të më shpëtojë nga ndjenja që po më çmend.

E pranoj se jam i krisur; por këtë krisje e dua shumë.

Mërzia është edhe më e madhe. Edhe pendesa.

Nëse ti s'e kalon mërzinë, ajo do të bëhet sërish e verdhë.

Është e parëndësishme se si ndihem unë!

Mjafton që të kesh besim, do të isha i lumtur edhe atëherë kur askush nuk ndihet i tillë.

Ti po e konteston teorinë e intertekstit, atë teori aq të dashur.

Derën e gjeta hapur, kurse letrën tënde mbyllur.

Ti je provë se e veçanta është misterioze, ose gjithçka që është misterioze është e veçantë.

Më vret heshtja, gjithë ky misteriozitet.

Shpesh mendoj se e tëra është fikson, se ti s'je.

Streha shpirtërore është rrënuar plotësisht.

Ndodhem në një udhëkryq emocional të egër.

Kurrë nuk kam qenë kaq i ndjeshëm.

Kam frikë se nga qenia ime e dikurshme nuk do të reflektojë mirësi.

Kjo më tmerron.

Vështirë se do të mund ta vazhdoj jetën.

Dhembja që ndiej le të kuptohet se ti je e vërtetë, se jeta shtrin errësirën brenda;

se të shoh në dritë të plotë; se të dua me zemrën e çmendur!

## EPISODI II

- Ta solla suvenirin si shpëtim.

- Suvenirin mundëson atë çka jeta s'mundet.

- Për mua tash s'ka ikje. Ky është mesi i detit për mua.

- Shpresoj që ti të kesh pasur ditë më pak të lodhshme.

- Dita ime është e mbushur me frymën tënde.

- Unë jam në terr. Më paska marr malli për suvenirin.

- Je shumë-shumë e mirë. A s'përgjigjesh ti?

- Jo, sepse dola në dritë nga fjalët e tua.

- Përgjigje e mençur. Ndoshta do të mund të më thoshe diçka që do ta mbushte dritë natën?

- Atëherë drita verbon.

- Shpresoj të më flasësh sonte, ose do të vdes (pa thonjëza) në fundin tragjik.

- Unë duhet të zgjedh: o jetën, o dashurinë.

- Ti e njeh natyrën time. Fjala jote ka fuqinë e pazakonshme për të më bërë të lumtur ose për të më lënduar sa s'mund ta marrësh me mend.

- Nuk dua të të mërzis. Nuk dua dashuri fatale. Dua ta gjejë forcën e shpëtimit nga katastrofa, ndonëse shpirti është i përjetshëm.

- Jo, jo, unë të kam mërzitur, prandaj po ndihem i palumtur. Më fal për të gjitha!

- Po përpiqem për ta rivendosur fatin e mëparshëm, përkundër variantit real apo imagjinar.

- Më fyen diskursi i panatyrshëm për ty.

- Pasionet e mëshirës nga qielli dhe frikës nga toka po ma vrasin dashurinë.

- Qoftë edhe frymën time do ta kesh për mbrojtje gjithmonë. Beso në ndjenjën tënde dhe në mallin tim. Vetëm ti mund të më duash aq sa të dua unë.

- Vetëm Zoti e di sa të dua.

## EPISODI III

- Shiko suvenirët e vdekjes mbi det dhe nën tokë.

- Ata barazohen me jetën. Ku je ti, aty ku është fryma jote vdekje s'mund të ketë.

- Asgjë s'po kuptoj nga jeta. Qielli shuan zjarrin.

- Realiteti shkel idealin.

- Kam frikë dhe po lutem për ne të dy.

- Të dua aq sa nuk mund të thuhet.

- Të kuptoj më tepër se sa duhet.

- Ti po sillesh si Zonjë e shpirtit tim. Më bën të lumtur.

- E kur mërzitesh çfarë bën?

- Kujtohem se të dua; pastaj bota rritet pafundësisht.

- S'ka kohë, s'ka hapësirë, s'ka jetë. Po troket fundi.

- Koha kërkon pritjen. Të dua më shumë se çdo herë!

- Njëherë sprovën e madhe të botës së vogël: T. D.!

- Natë nuk ka edhe shumë. Unë do të jem zgjuar. Dhe fryma jote me mua.

- Natën e mirë!

## EKSODI

Shpresoj që së paku dhembjen ta kem për vete.

Respektoj heshtjen duke heshtur më thellë se ti.

Do të ta ruajë botën duke sakrifikuar lumturinë.

Do të të jap çdo gjë pa asnjë kushtëzim.

Dashuria është e plotë dhe besimi i pakufishëm.

Dashuria s'ka si bëhet tjetër në kohë.

Koha është tirane, plotësisht e pandjeshme, nëse s'ia japim frymën tonë.

Nëse kjo s'është kohë ideale, duhet të ketë edhe një kohë tjetër, një botë tjetër.

E pres atë kohë me mall.

Nëse s'ka kohë të tillë, do t'i kem humbur shpirtin.

Mund të dukem i krisur, por besoj në kohën ideale.

I mbytur në trishtim, i besoj ndjenjës tënde pa masë.

Ndjenja largon hijet.

Shpirti kurrë s'ka qenë më i pastër se në këtë çast.

Nga ky çast do të jetoj sa për t'i plotësuar ditët që m'i ka dhënë Zoti.

Nëse streha ime shpirtërore do të jesh ti përgjithnjë,

ashtu siç ndodh me një ëndërr të gjatë e të dashur,

shpirti im nuk do të preket kurrë nga e liga.

Nëse ndodh ndryshe, s'do të jem tjetër pos një hije që ka humbur lirinë e vet.

Kam nevojë të tmerrshme për ty.

Ndjenja për ty është ndjenja e jetës sime.

Çdo gjë tjetër është hije.

Ti mbulon me dritë dhe mbron qenien time, pastaj Zoti mbron muzullimin.

Ti do të jesh gjaku i vetmisë sime.

Të dua sa vetëm shpirti arrin ta thotë.

Kurrë s'kam dashur dikë si ty.

Kurrë s'do të mund ta dua dikë tjetër.

Jam i çmendur pas teje, këtë s'ia kam thënë kurrë askujt.

Do të jetoj me durimin e mallit për ty.

Do të vdes në dritën e mallit.

Kjo dritë po më çmend, por vazhdoj ta dua më shumë se çdo gjë në botë.

Lutem që të mos vdes i çmendur.

Të dua, kam me të dashtë sa të jem gjallë, kam me të dashtë edhe pasi të vdes!

Jurisprudenca dhe shteti

# Të menduarit dhe të shkruarit juridik

**Detyra e tyre kritike shtetërore dhe ruajtëse shtetërore i bëjnë ato të pashmangshme për një formë shtetërore demokratike. Shteti dhe qytetarët duhet ta kuptojnë se këto detyra janë të pandashme nga njëra-tjetra dhe se çdo vlerësim i njëanshëm mund të rrezikojë si të drejtat e qytetarit, ashtu edhe ekzistencën e shtetit.**



Islam PEPAJ

**N**ë periudhën ndërmjet shekullit XVIII dhe XIX disa shtete filluan t'i rregullojnë raportet e tyre në dobi të qytetarëve, apo më mirë të themi brenda këtyre shteteve filloi të zhvillohet një lloj demokracie. Ndër këto shtete janë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të cilat formuluan kushtetutën e parë të shkruar në dobi të sovranitetit popullor dhe të Kontratës Shoqërore. Pas kushtetutës së SHBA-ve, edhe një numër jo i vogël i shteteve filloj që me kushtetutat e tyre t'i mbrojnë të drejtat e qytetarëve dhe të definojnë si shtete në të cilat merret për bazë sovraniteti dhe e drejta e qytetarëve në vendimmarrje. Këtë të drejtë, këto shtete, e futën mbi parimin se qeveritë e tyre duhet të jenë të popullit, dalin nga populli dhe duhet të punojnë për popullin. Por edhe pas kësaj periudhe ndodhi që brenda shumë shteteve të mos merret për bazë fjala e popullit dhe as të mendohet për vendimet të cilat merren nga populli. Por zbatimimi kësaj të drejte edhe sot vazhdon të mos respektohet nëpër disa vende, edhe pse demokracia dhe të drejtat e njeriut konsiderohet se kanë përparuar shumë në botën bashkëkohore.

Nëse pushteti është i popullit, si të bëhet vërtet i popullit? Shikuar historikisht, të gjitha vendet demokratike të botës bashkëkohore gjatë hartimit të kushtetutave të tyre rëndësi të posaçme i kanë kushtuar faktit se pushteti është i popullit dhe duhet t'i takojë atij. Mbi këtë parim është themeluar Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si kushtetuta e parë e shkruar dhe demokratike, ku në brendësinë e sajë në lidhje me sistemin qeverisjes së vendit, vullneti i popullit merret si bazë. Kjo kushtetutë është kombinim i "shkathtësive dhe ideve të mendimtarëve dhe filozofëve të shquar të asaj kohe, si John Lock, Ruso dhe Monteskie". Kjo kushtetutë u ndërtua mbi idetë e këtyre mendimtarëve, për arsye se të gjithë këta filozofë mendimet e tyre i bazonin në sovranitetin popullor dhe në "Kontratën Shoqërore". Ideja e

themeluesve dhe e përkrahësve të kësaj kushtetute ishte që pushteti t'i takojë popullit dhe populli të ketë të drejtë në vendimmarrje. Arsyeja e dytë ishte zbatimimi i Kontratës shoqërore si frymëzim i Zhan Zhak Ruso-s, që do të thotë se të qeverisurit (populli) lidhin marrëveshje me qeverisësit (udhëheqësit) përmes zgjedhjeve dhe qeverisësit duhet të punojnë dhe vepronë sipas udhëzimeve dhe direktivave të popullit.

Një rast tjetër i deklarimit të shtetit se pushteti është i popullit është edhe themelimi i kushtetutës së pestë të Francës (Kushtetuta e Degolit). Hartuesit e kësaj kushtetute janë bazuar në idenë e Abraham Linkolnit, ku thotë se "qeveria është e popullit, rrjedh nga populli dhe duhet t'i takojë popullit". Këta janë dy shembuj nga dy shtete të cilat në arenën ndërkombëtare njihen si vende demokratike dhe si vende ku merret për bazë fjala e popullit. Këto dy shtete janë vende ndër të shumtat e atyre që pretendojnë se pushteti është i popullit. Por pavarësisht këtyre deklarimeve kemi raste kur populli as që pyetet kur kemi të bëjmë me lloje të ndryshme të vendimmarrjes. Si shembull në këtë drejtim "shërben fati i demokracisë në Algjeri, ku më 26 dhjetor 1991, zgjedhjet parlamentare përfunduan me fitoren e Frontit të Shenjtë Islamik". Qëllimi i tyre i deklaruar ishte heqja e të gjitha elementeve të demokracisë perëndimore në të mirë të shtetit islamik të Zotit. Ky

zhvillim u pengua përmes ndërhyrjes së ushtrisë, duke arrestuar fituesit e zgjedhjeve dhe duke penguar në këtë mënyrë me mjete jodemokratike "soveranin", pra popullin zgjedhës në zëvendësimin në mënyrë demokratike të demokracisë me një sistem totalitar. Ky shembull tregon njëkohësisht se siguria sociale, apo pushteti i popullit, janë premisë e rëndësishme për një demokraci funksionale.

Në demokraci, procesin politik mund ta nxisin dhe ta çojnë përpara edhe pakicat, sepse "koncepti i qeverisjes së shumicës nuk nënkupton shtypjen e pakicës dhe injorimin e saj në jetën politike". Ky fakt e gjen shpjegimin e tij në zgjerimin e aktivitetit të shtetit dhe në ndërlikimin gjithnjë e më të theksuar të shoqërisë. Ndjenja e mos prejkes nga veprimet politike apo nënshtrimi para tyre shkakton apati (plogështi) politike. Në këtë mënyrë, përballë shumicës pasive dalin ekspertët e informuar, të cilët mbajnë shumë pak kontakt me të prekurit. Si rrjedhojë e kësaj, në një pjesë të popullsisë ndodhin reaksione, të cilat shtrihen që nga pakënaqësitë dhe refuzimi, e deri te përdorimi i dhunës. Ky zhvillim natyrisht paraqet rrezik për konsensusin e domosdoshëm në demokraci.

Autori De Tokvil në librin e tij kushtuar demokracisë në Amerikë, nuk e përshkroi natyrën e demokracisë duke u nisur nga "strukturat e rendit kushtetues



Pjesë nga kushtetuta e SHBA-ve!

apo procedurat në institucionet politike, por duke u nisur nga premiset e tij antropologjike". Njerëzit, sipas Tokvil-it, në përgjithësi nuk janë më egoistë se paraardhësit e tyre. Por, ndikimet e mentalitetit demokratik shkaktojnë një përshtatje të madhe ndaj kushteve dhe formave të shprehjeve të njeriut. Në këtë epokë, njeriu i përkushtohet me pasion lirisë dhe njëkohësisht kërkon njohjen përmes barazisë me të tjerët. Nga kjo, mosbesimi rritet dhe njëkohësisht rritet tendenca për t'iu nënshtruar mendimit publik, apo asaj që paraqitet si i tillë. Nga shtytja për liri, sipas Tokvil-it, lind nënshtrimi para ligjeve të barazisë me një "presion të jashtëzakonshëm të frymës së masës mbi mendjen e individit". Dhe kur ky presion kalon mendjen e njeriut, njeriu disi nuk është edhe shumë i pirur që të ketë pushtet në vendimmarrje.

Si të bëhet vërtet pushteti i popullit? Zhan Zhak Ruso në veprën e tij "Kontrata Shoqërore" e mbështet mendimin e tij kur thotë se "vullneti i përgjith-

shëm (populli) gjithëherë ka të drejtë sepse është i orientuar nga dobia publike". Edhe pyetjes se: si të bëhet vërtet pushteti i popullit?, - ky mendimtar jep përgjigje duke thënë, se në qoftë se qeverisësit do të mbanin mbledhje të vazhdueshme me qytetarët, për shkak të numrit të madh të ndryshimeve të vogla, atëherë do të buronte vullneti i përgjithshëm dhe vendimi gjithnjë do të ishte i mirë dhe në dobi të qytetarëve. Edhe në ditët tona, në demokracinë të cilën jemi duke e përjetuar, ndodhin mbledhje dhe konsultime me qytetarët, por këto janë shumë të rralla. Si shembull mund të marrim mbledhjet të cilat mbahen më qytetarët, apo siç quhen tubime publike, dhe këto mbahen vetëm dy herë brenda vitit në Komunat përkatëse. Mendoj se qeverisësit nuk mund të shpjegojnë apo të kërkojnë ndihmën e qytetarëve për problemet e një viti, vetëm për dy herë që takohen brenda kësaj periudhe. Demokracia, sipas Bryce, nuk është "pushtet përmes popullit", por për popullin. "Populli shpreh si qëllim të

pushtetit mirëqenien e tërë shoqërisë e jo të një pjese të privilegjuar. Ai ia lë mjetet për arritjen e këtij qëllimi bashkëqytetarëve, të cilët janë të përshtatshëm për këtë detyrë. Populli i kontrollon këta qytetarë të zgjedhur, me qëllim që këta të mos e keqpërdorin autoritetin e besuar". Bryce, ashtu si De Tokvil, përmend rëndësinë vendimtare të lirisë së shtypit, dhe të mendimit të publikuar, si forma ku qytetarët mund t'i shprehin mendimet e tyre në dobi të qeverisjes së mirë. Liria e shtypit nuk ka dyshim se është atribut i demokracisë dhe mendoj se kjo liri mund ta lehtësojë pjesëmarrjen e popullit në qeverisje, sepse qytetarët nga mediat vetëdijesohen për probleme të shumta që ndodhin brenda shtetit, dhe vetëdijesimi i tyre mund të interveneroj në mënyra nga më të ndryshmet. Të një rëndësie tjetër janë edhe mendimet e publikuara, ku përmes së cilave qytetarët shprehin brengat e tyre për mirë apo keq qeverisjen, dhe përmes këtyre publikimeve, qeverisësve i tërhiqet disi vëmendja për masat të cilat duhet të ndërmerren në të ardhmen, apo edhe për lëshimet që kanë bërë.

**Përfundim**

Historia e të drejtave themelore bën të qartë zhvillimin e këtyre të drejtave, të paraqitura në fillim si të drejta të lirisë, më pas si të drejta të pjesëmarrjes kundrejt mbretit dhe aristokracisë. Ato përmbanin që nga fillimi edhe detyrën për përgjegjësi politike. Me kalimin në sovranitetin e popullit, pjesëmarrja u shndërrua në vetësundim, por edhe këtu secilit i takon vetëm pjesa e tij e pushtetit. Në demokraci ka ndryshuar kuptimi i pjesëmarrjes në: jo një "pjesë e mishëruar" në pushtet, por bashkëvendosja e përcaktuar në bazë të së drejtës themelore për barazi siguron mundësitë politike të individit. Në këtë mënyrë, të drejtat themelore nuk kanë vetëm rëndësi funksionale, por ato shndërrohen në "të drejta statusore demokratike", të cilat, duke siguruar vetëvendosjen individuale dhe bashkëvendosjen politike të qytetarëve, e shndërrojnë rendin politik në "shoqëri". Demokracia vazhdon të mbetet e gjallë si formë e rregullimit shtetëror vetëm në rast se të drejtat statutoare nuk kuptohen nga të gjithë qytetarët vetëm si mundësi, por edhe shfrytëzohen realisht në përditshmërinë politike dhe shoqërore. Rreziku i heqjes së ligjshmërisë së të drejtave themelore (...) sot është më i vogël (ndoshta edhe i përjashtuar) se sa kërcënimi nga mosnxitja nga ana e shtetit dhe mospërfillja nga ana e qytetarëve. Detyra e tyre kritike shtetërore dhe ruajtëse shtetërore i bën ato të pashmangshme për një formë shtetërore demokratike. Shteti dhe qytetarët duhet ta kuptojnë se këto detyra janë të pandashme nga njëra-tjetra dhe se çdo vlerësim i njëanshëm mund të rrezikojë si të drejtat e qytetarit, ashtu edhe ekzistencën e shtetit.



► **Ligji godet vetëm drejtë!**

Sëmundjet dhe stina e verës

# ETHET HEMORRAGJIKE, ANKTH I DITËVE TË NXEHTA

Tash të gjithë po ëndërrojmë ditët e nxehta, ditët kur bashkë me familjen ose me një shoqëri të mirë do t'i kalojmë në një ambient të hapur, larg zhurmës së makinave dhe pluhurit të qytetit. Por sa më shumë që afrohen këto ditë të këndshme aq më tepër ne rrezikohemi nga një sëmundje infektive "Ethet Hemorragjike". Është e mundur që secili nga ne të infektohet por nuk është e pamundur të mbrohemi nga ky shkaktar i cili din të jetë vdekjeprurës.

Artan BEJTA & Iliriana ALLOQI

Jemi në sezonin ku tanimë kanë filluar të ngritën temperaturat. Si pasojë e kësaj jemi të rrezikuar nga një epidemi jo e rrallë në vendin tonë. Ngritja e temperaturave ndikon dhe është një prej faktorëve kyç në paraqitjen e "Etheve Hemorragjike". Ethet hemorragjike në vendin tonë kanë filluar të paraqiten si raste sporadike e po ashtu si epidemi ku janë të njohura epidemitë e viteve 1986, 1989, 1995, 2001, 2004 dhe 2005. Futet në grupin e sëmundjeve të rrezikshme infektive. Janë të njohura 12 lloje të etheve hemorragjike në botë mirëpo në vendin tonë janë të njohura dy lloje dhe atë ethet hemorragjike me Sindrom Veshkor (EHSR) ose ethe të minjve si njihet në popull dhe ethet hemorragjike krime kongo (EHKK) ose ethet e rriqrave. Sezonet gjatë të cilave shfaqet kjo epidemi janë sezonet e pranverës, verës dhe fillimi i vjeshtës pikërisht për arsye të temperaturave të larta që e favorizojnë paraqitjen e kësaj sëmundje epidemike.

Këto dy sëmundje që hyjnë në grupin e sëmundjeve të rrezikshme ngjitëse janë me vdekshmëri të lartë dhe për fat të keq janë të shpeshta në vendin tonë. Kanë karakter sezonal (paraqiten në stinët e ngrohta) dhe janë të lidhura ngushtë me faktorët ekologjikë dhe klimatik të vatrave natyrore.

## ETHET HEMORRAGJIKE KRIME-KONGO

Shkaktari i sëmundjes është një virus i cili jeton në shtazë të ndryshme si lepuj të egër, disa lloje të zogjve, rriqra që përkohësisht gjenden në shtazë shtëpiake si lopë, dele, dhi, kuaj etj. Është sëmundje ngjitëse e rrezikshme

me vdekshmëri të lartë dhe e cila fillon në mënyrë të shpejtë me temperaturë dhe ethe.

Në fillim shfaqet skuqja e fytyrës, e shoqëruar me skuqje të gjoksit dhe të syve, e më vonë pasi sëmundja të përparon, paraqitet gjakderdhja, fillimisht në mukozë (gojë e hundë) si dhe në lëkurë në regjionin e barkut, kraharorit e deri në shpinë e në fazat e mëvonshme i sëmuri ka gjakderdhje me intensitet të madh nga të gjitha vrimat e trupit.

Si bartës të etheve hemorragjike Krime Kongo janë rriqrat të cilët zakonisht gjenden në vendet me një lartësi mbi detare 400-1000 metra, këto vende zakonisht janë blegtorale, të pasura me kullosa, d.m.th. janë zona bujqësore, pyje të vogla dhe lumenj. Komunitat më të rrezikuara nga kjo sëmundje janë Malisheva, Drenasi, Klina, Skenderaj, regjioni i Prizrenit, Hasit, e në raste sporadike edhe në regjionet tjera.


Njeriu nga kjo sëmundje më së shpeshti

infektohet nga pickimet e llojeve të ndryshme të rriqrave që në vete përbajnë shkaktarin e etheve hemorragjike Krime Kongo (EHKK), e po ashtu nuk janë të rralla edhe infektimet përmes kontaktit me gjakun e njeriut të sëmurë nga kjo sëmundje. Edhe pse më të rralla janë të njohura edhe mënyra tjera të infektimit me këtë virus dhe atë kur ndrydhet rriqri, me këputjen e trupit të rriqrit gjatë nxjerrjes nga lëkura e shtazës dhe me prerjen e rriqrit gjatë qethjes së deleve. Vlen ta përmendim se sëmundja përcillet nga njeriu i sëmurë tek ai i shëndoshë, zakonisht te ata persona që përkujdesen për të sëmurin si familjarët apo edhe personeli shëndetësor.


### Masat mbrojtëse

Më së miri është që t'i ikim qëndrimin në vendin ku janë vatrave natyrore të sëmundjes, të mos dalim në piknik, fushim apo edhe në kullosat e bagëtive e nëse duhet patjetër të bëhen këto punë

Statistikat e Etheve Hemorragjike Krime Kongo në Kosovë 1995-2006



Të dhënat sipas Institutit të Shëndetësisë Publike



atëherë duhet marrë masat mbrojtëse (siç janë rrobat e gjata, mangët të lidhen, po ashtu pantallonat të futën nën çorapë).

Është shumë me rëndësi që njeriu të kontrolloj vetën kohë pas kohe se mos është thumbuar nga ndonjë rriqër, e nëse ndodh që njeriu të thumbohet nga rriqri, atëherë nuk duhet provuar që të hiqet vetë rriqri nga trupi por kjo punë duhet t'i lihet punëtorit shëndetësor, pra, njeriu i pickuar nga rriqri duhet menjëherë të lajmërohet në institucionin shëndetësor më të afërt e më së miri është që të lajmërohet gjashtë orës së para të pickimit nga rriqrat. Po ashtu personeli mjekësor duhet të jetë i pajisur me mjete mbrojtëse siç janë dorëzat në mënyrë që të sigurohet nga infeksioni me gjakun e njeriut të sëmurë..

## **ETHET HEMORRAGJIKE ME SINDROM VESHKOR OSE ETHET E MINJVE**

Është po ashtu sëmundje ngjitëse shumë e rrezikshme e si burim infek-



sionit më së shpeshti janë minjtë e pyllit dhe të fushës. Brejtësit në këtë rast nuk manifestojnë shenjat e sëmundjes mirëpo ata eliminojnë shkaktarin e kësaj sëmundje në këtë rast virusin me anë të feqeve, urinës, pështymës pas infektimit të tyre. Kjo sëmundje infektive është e përhapur në zonat malore



me lartësi mbidetare 500-2000 metra, vlen të ceket se në Kosovë janë të rrezikuara sidomos rajoni i bjeshkëve të Rugovës, Gjeravicës, Strellcit, Burimit pasi që në këto zona kushtet klimatike janë të tilla që i përshtaten jetesës së bartësve të sëmundjes.


Deri te infektimi i njeriut, vjen kur njeriu është në kontakt me minjtë dhe me gjësendet të cilat ata i kanë kontaminuar me feqet ose urinën e tyre e kjo zakonisht ndodh gjatë punëve në fshat, pyje, gjatë kampingut apo edhe gjatë gjuetisë si dhe gjatë kërkimit të frutave të pyllit siç janë dredhëzat, kërpudhat

ose edhe fruta dhe bimë tjera të ndryshme.

Sëmundja zakonisht fillon shpejt me temperaturë të lartë e cila është zakonisht e shoqëruar me ethe, plogështi, marramendje, kokëdhimbje, humbje të oreksit, vjellje e në stadet më të avancuara të kësaj sëmundje paraqiten gjakderdhje si dhe dëmtim i veshkave që shpesh mund të qojë edhe deri te bllokimi i punës së tyre e të përfundoj në mënyrë fatale. Vlen të ceket sëmundja nuk përhapet nga njeriu në njeri.

## **Masat mbrojtëse**

Mundësisht mos të jemi në kontakt me bartësit e sëmundjes (brejtësit) siç u theksuan më lart duke u ikur vendeve ku gjenden këta bartës. Po ashtu ka rëndësi shumë të madhe që ushqimi të ruhet që mos të jetë në kontakt me minjtë, mos të ushqehemi me pemë dhe perime pa i pastruar ato mirë. Pas punës në fushë të bëhet pastrimi i duarve e rëndësi të posaçme ka edhe klorimi i ujit në puse (bunare).



Sporti në Kosovë

# NGECJET JANË EVIDENTE, DUHET PUNUAR PËR NGRITJEN E CILËSISË

**Në përgjithësi sporti kosovar ka shënuar progres në aspektin e funksionalitetit dhe avancimit të tij, mirëpo ngeçjet janë evidente. Prandaj nevojitet një angazhim i gjithë strukturave udhëheqëse të sportit në vendin tonë për mënjanimin e tyre.**

**Sead UJKANI**

**T**ash e tetë vite pas përfundimit të luftës sporti kosovar në përgjithësi ka shënuar progres të theksuar në rrugën e përpunimit dhe zhvillimit cilësor të tij në vendin tonë.

Mirëpo nëse i hedhim një sy asaj që është arritur dhe gjendjes momentale përfundojmë se me gjithë të arriturat në drejtim të instancionalizimit dhe funksionalizimit sa më të mirë të sportit në vendin tonë, ende ka ngeçje. Këto ngeçje janë evidente sidomos në tri aspekte kryesore:

1. Në drejtim të implementimit të ligjit për sport, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës me të cilin rregullohet organizimi, kushtet dhe mënyrat e zhvillimit të veprimtarive sportive dhe çështjet e tjera lidhur me funksionimin e organizatave sportive duke filluar nga themelimi, regjistrimi dhe menaxhimi i tyre;
2. Në drejtim të organizimit dhe strukturimit të federatave dhe klubeve sportive konform dhe në pajtueshmëri të plotë me Ligjin për Sport, statutet përkatëse të federatave dhe standardeve ndërkombëtare të sportit;
3. Në drejtim të përmirësimit dhe zhvillimit të infrastrukturës së sportit.

Implementimi dhe aplikimi i dispozitave juridike të Ligjit për Sport duke përcaktuar dhe zbatuar politikat e përgjithshme dhe strategjinë e zhvillimit të sportit në përputhje me prioritetet dhe objektivat e ngritjes së vazhdueshme të cilësisë së sportit, do të luante rol vendimtar në procesin e avancimit të sportit. Në këtë drejtim, Ministria e Sportit si organi më i lartë udhëheqës i sportit në vendin tonë në përgjithësi, do të kishte rolin e vet të rëndësishëm duke realizuar dhe siguruar të gjitha rrethanat dhe kushtet për zhvillim cilësor të sportit siç përcaktohet edhe në nenin 8.1 të Ligjit për Sport: "Ministria përkatëse, përcakton politikat e përgjithshme të zhvillimit të sportit, në përputhje me prioritetet

e masivizimit dhe të ngritjes së cilësisë së tyre. Ajo krijon kushtet infrastrukturale, financiare dhe kadrovike për përmbushjen e objektivave të caktuara".

Një element tjetër me rëndësi paraqet edhe strukturimi i organizatave sportive në përshtatje me praktikën menaxhuese bashkëkohore në sport, duke përfshirë këtu njohjen dhe kultivimin e tyre. Funksionimi si në aspektin organizativ ashtu edhe në atë hierarkik në përputhje me kriteret ndërkombëtare të sportit do të ishte me rëndësi të veçantë në rrugën e profesionalizimit të mëtutjeshëm të tyre.

Infrastruktura sportive paraqet elementin më të domosdoshëm për zhvillimin kualitativ të veprimtarive sportive dhe për fatkeqësi njëherësh elementin që më së shumti i mungon sportit të Kosovës, kjo për arsye të: pasojave të luftës në infrastrukturën e përgjithshme por edhe në atë të sportit, investimeve të zbehta në këtë lëmi marrë në përgjithësi gjatë njëzet viteve të fundit, trajtimit jo adekuat gjatë fazës

së rindërtimit të vendit pas luftës, situatës së vështirë ekonomike në vend, etj. Prandaj kërkohet angazhim i madh. Ministria e Sportit dhe organet përkatëse udhëheqëse sportive duhet të jenë më këmbëngulëse dhe duhet të punonë më shumë për arritjen e nivelit të dëshiruar, duhet të sigurojnë mjete të mjaftueshme për projektimin dhe ndërtimin e objekteve të reja sportive si dhe përmirësimin e atyre ekzistuese, në mënyrë që të mundësohet ecuri cilësore e gjitha aktiviteteve sportive në vendin tonë.

Natyrisht nevoja për përmirësime është evidente edhe në lëmi të tjera, mirëpo elementet e lartpërmendura gëzojnë rëndësinë primare të mobilizimit të gjithë organeve udhëheqëse të sportit në Kosovë për avancimin e tyre duke krijuar kështu një terren të përshtatshëm edhe për përmbushjen e prioriteteve dhe objektivave të tjera në mënyrë që sportit në vendin tonë t'i sigurojmë një ardhmëri të ndritshme të zhvillimit cilësor dhe lehtësi për avancim në nivelet ndërkombëtare.



Intervistë me solistin dhe kompozitorin e grupit Fisnikët, Agim Gërguri

# NUK DIN PUBLIKU SE ÇKA PO DËGJON

Është një krizë muzikore në përgjithësi...më nuk po dinë as publiku se cka po dëgjon ka hupë shija e muzikës por shpresoj që do bëhet mirë dhe unë jam i kënaqur dhe i habitur për të mirë që këngët tona ende po dëgjojnë pas sa e sa dekadave, kjo edhe po me shtynë të punoj më tutje.

**P**AQJA: Ka një jetë të tërë që këndoni, që jeni në skenë, a mund të na thoni kur keni filluar të këndoni për herë të parë si grup?

**Agim Gërguri:** Për herë të parë si grup kemi filluar në vitin 1979, po mendoj ushtrimet, kurse publikisht kemi dalë në vitin 1982 ne Boom festivalin e parë të rock- muzikës Kosovare

**PAQJA: Cila ishte kënga e parë e kënduar?**

**Agim Gërguri:** Kënga e parë që kam komponuar ka qenë "Gjurma" e shkruar nga Dritëro Agolli në vitin 1979.

**PAQJA: Kush e ka zbuluar talentin tuaj për muzikë?**

**Agim Gërguri:** Po talentin mundet vetëm Zoti me ta dhuru, kurse të tjerat vijnë qysh ja ban hyzmetin... pra unë kur e kam kuptu se kam talent jam angazhu, së pari kam fillu me kitarë, pastaj me këndu e kështu me radhë.

**PAQJA: Sa këngë keni kënduar deri me tani?**

**Agim Gërguri:** Nëse mendoni sa i kam komponu.. se me këndu i kam këndu me mijëra e mijëra...kurse i kam komponu nja 40 deri tash.

**PAQJA: Sa albume keni edituar?**

**Agim Gërguri:** Tre albume në studio dhe një "live" dmth gjallë, pra gjithsejt katër deri më tani.

**PAQJA: Cila është kënga që e këndoni me më dëshirë?**

**Agim Gërguri:** Po nuk mund ti ndaj...e ke pa sikur kur i ke fëmijët e tu dhe asnjërin s`mund ti ndash e të thuash këtë e dua më së shumti...por prap jam i lidhur disi tepër

m e

këngën "Bukuria" apo sic quhet në popull...do të shkrihem.

**PAQJA: Si ndiheni në skenë edhe pse ka shumë vite që këndoni, a ka diçka të veçantë?**

**Agim Gërguri:** Në skenë gjithnjë ndihem shumë mirë, tani normal e kam një përvojë me goxha disa vite punë, por prap është ajo trema që më mban dhe më kujton ku gjindem dhe më mbron që mos të habitem.

**PAQJA: A na kujtoni diçka që ju ka mbetur në kujtesën tuaj gjatë karrierës si grup muzikor – ndonjë moment interesant?**

**Agim Gërguri:** Po ka shumë momente, gjithnjë ka si të them batuta të vogla që janë të momentit e që ndodhin saherë jemi duke performuar dikun... ato janë të rastit.. prandaj s'po di çka të veçoj.

**PAQJA: Sa herë që ju shohim në skenë jeni në formë, me veshje elegante si gjithmonë. Kush kujdeset për gardërobën tuaj?**

**Agim Gërguri:** He he, në formë po, por sa për veshje nuk i jap edhe aq rëndësi të tepruar...tërë ditën vishem në mënyrë sportive..e kur këndo kam disa tesha më të "mira".

**PAQJA: A e keni menduar ndonjëherë të jeni prezantues i programeve të ndryshme?**

**Agim Gërguri:** Po valla me të tregu drejt...bile shpesh kam menduar me e ba një program humoristik..por kurr nuk e kam finalizuar...për shkak të punëve të tjera..edhe angazhimeve.

**PAQJA: A ju ka ndodhur ndonjëherë në ndonjë koncert që të mos ndjeheni mirë?**

**Agim Gërguri:** Po ka momente emotive, tash spo di çka me veçuar..

**PAQJA: Edhe pse vete jeni këngëtar, besoj se ka ndonjë këngëtar apo këngëtare të huaj që ju pëlqen?**

**Agim Gërguri:** Po normal që ka...edhe ka pasë qysh kam filluar..p.sh. i kam degjuar shumë Beatles...Stivi Vonder..Brus Springstin Vitni Hjuston etj.

**PAQJA: Cilat janë planet tuaja për të ardhmen si grup muzikor?**

**Agim Gërguri:** Po të vazhdojmë të këndojmë deri sa të mundemi...tani në vitet e fundit ka kriza..është një krizë muzikore në përgjithësi...më nuk po dinë as publiku se cka po dëgjon ka hupë shija e muzikës por shpresoj që do bëhet mirë dhe unë jam i kënaqur dhe i habitur për të mirë që këngët tona ende po dëgjojnë pas sa e sa dekadave, kjo edhe po me shtynë të punoj më tutje.

**PAQJA: Çfarë pret nga ky vit?**

**Agim Gërguri:** Unë do të punoj këngë të reja, e kur do ta shohin ato dritën nuk varet prej meje por prej atyre që e blejnë programin.

**PAQJA: Mesazhi juaj për lexuesit?**

**Agim Gërguri:** Për lexuesit, le të vazhdojnë të lexojnë gazetën tuaj dhe ti dëgjojnë Fisnikët.

**Intervistoi  
Ilir DESKU**



**Ilir DESKU**

**Kur Kosova pret statusin**

Në një vend të largët  
Në këshillin e sigurimit  
Kishte filluar ideja  
Për planin e pavarësimit

Çfarë po ndodh në Kosovë  
E kush e tha i pari  
Se gjoja pavarësinë do na e sjellë  
Njëfarë Marti Ahtisari

Pritem shtatë vjet të plota  
Hiç pa hezitim  
Me në po luan Evropa  
sikur në aktrim

Ëndërr apo zhgjëndërr  
Politika kështu e ka  
pa i plotësu mirë standardet  
pavarësi për ne nuk ka

Për një vizitë të shkurtër  
Në Tiranë erdhi XH.BUSHI  
Mendjen si gjithëherë shqiptarëve  
Edhe kësaj radhe ia mbushi

Shikoni thoshte Bushi  
Dhe bënte me njëren dorë  
Sa të rrojë Amerika  
Rusia veto nuk do të përdorë

E atje në Beograd  
Mjaft u diskutue  
Për pavarësi të Kosovës  
Askush s'u pajtue

Kështu thoshte historia  
Se 'deti u bo kos'  
E për fatin e shqiptarëve  
Gjithëherë tjetër kush vendos

Se politikanët tanë  
Nuk janë zgjedh për tjetër  
Veç Kosovës sonë  
T'ia bëjnë edhe një plagë tjetër.

Ndoshta këto ditë do të ulen  
Për të bisedu: Amerikani e Rusi  
Sepse me rëndësi për ne është  
Të mos shtyhet STATUSI

**PROVERBA TË NDRYSHME**

1. Udhëtimi është jeta, ashtu siç është edhe e kundërta jeta udhëtim – P. Jean
2. Në udhëtimin e gjatë edhe fija e kashtës është e rëndë – Proverb spanjoll
3. Me lutjen e artë përfitohen edhe zemrat me të ngurta – A. Tibullus
4. Nëse dëshiron që të gjithë të të urrejnë, thuaj çdonjërit në sy se cili është ai – Proverb popullor
5. Askush nuk skuqet në terr – Proverb anglez
6. Nuk është turp të rrëzohesh, por të mbetesh i shtrirë – Proverb popullor
7. Ai që mbjell urrejtje, nuk mund të korrë dashuri – Proverb popullor
8. Njeriu pa para e përshkon shpejt pazarin – Proverb skocez
9. S'ka gjë me të tmerrshme sesa të mbetesh i vetmuar në mes njerëzve – S. Zweig
10. Zemra është pasuri që as nuk shitet dhe as nuk blihet, por vetëm dhurohet –G. Flaubert
11. Reklama është gënjeshtë e lejuar me ligj – H. G. Wells

**BARCOLETA**


**Berberi**


Një njeri, pothuajse i tëri tullac, shkon te berberi për t'i shkurtuar flokët. "Sigurisht, zotëri berber se nuk do të më kërkon shumën e njëjtë të të hollave, sikurse edhe të tjerëve sepse edhe ti po e sheh se sa flok kam - shtoi klienti.

"Po, në rastin tënd është e vërtetë se unë nuk kam shumë për të shkurtuar, por do të humbi shumë kohë duke hulumtuar për t'i gjetur qimet" - tha berberi.

**Vetëvrasja**

Njëherë një njeriu i ishte mërzhitur jeta aq shumë, sa që nuk dinte se çfarë të bënte dhe një ditë prej ditësh merr një litar dhe shkon afër një lumi. Aty sheh një pemë. E merr litarin dhe e lidh tek pema dhe pastaj e vendos në qafën e tij, mirëpo në momentin kur tenton që ta varë veten, thyhet dega dhe bie në lumë sa që mezi shpëton dhe pasi del prej lumit ndalet dhe thotë: I mjeri unë për një të varur gati sa s'u mbyta në lumë.





## HORIZONTALISHT

1. Bor – Flor – K – B 2. Aktor amerikan – periudhë kohore (shq.) 3. E vërteta – hov, vrull 4. Që ka të bëjë me oratorinë – afirmacion, çek 5. Mendjehollë – banor i Tetovës 6. Lumë në Sudan – rok bendi shqiptar (FOTO) 7. Qeni nga filmat ... tin tin – ultësirë në Afrikë 8. Një kontinent (pashq.) – lumë në Austri 9. Numri i Ludolfit – Isa Boletini 10. Njësia e rezistencës elektrike – liman në Izrael 11. Lumë në Vietnam – azot – njuton 12. Enë prej qelqi (shq) – etazh 13. Siemens – urani – qytet në Itali 14. Vend në Pakistan – T.A.M. 15. Letër bixhozi që fiton mbi të tjerat – Federation Internationale de Documentation 16. Dhënie arome 17. Çarmatimi 18. Mjeshër kamere (shq.) – Ismet Peja 19. Solistja turke, Koshan – grup ishujsh në oqeanin Atlantik – regjisori shqiptar, Pali 20. Gjarpër i madh i viseve tropikale (shq.) – kuzhinë popullore pranë xhamisë

## VERTIKALISHT

1. Armend Rexhepagiqi – g – d 2. Soliste jona – grup sportistësh 3. Të paralizuarit – prijësi i Kozakëve 4. Liqen në Hungari – Ceremoni zyrtare me rastin e hapjes së një objekti (sh shq.) 5. Majmuni nga filmat me Tarzanin – britma e toreadorëve – oksigjen 6. Ngadhënjim – skitari silloven ,Tepesh 7. Lumë në Poloni – Litri – teritor komune (shq.) 8. Pezmatim i veshit – vendi ku buron uji 9. Iki (pavet.) – Persia 10. Energjia – shkronjë greke – vend në Afganistan - metri 11. Tetova – O.P. – shkencë natyrore 12. Vesh rrushi (shq.) – të anketuarit (shq.) – ora (gjerm.) 13. Markë e TV aparateve – që i takon akademisë 14. Vendësit, banuesit – kategori në boks – llojet.